



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.20

2001

Maj

### P Ë R M B A J T J A

|                                       |  |     |
|---------------------------------------|--|-----|
| Vendim i KM<br>nr.219, datë 13.4.2001 | Për shpërblimin e anëtarëve të këshillave të qarkut, të bashkisë, të njësive bashkiake të Tiranës, të komunave dhe të kryetarëve të fshatrave..... | 601 |
| Vendim i KM<br>nr.228, datë 13.4.2001 | Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre.....  | 602 |
| Vendim i KM<br>nr.238, datë 13.4.2001 | Për kriteret e dhënies së lejes për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet.....  | 603 |
| Vendim i KM<br>nr.239, datë 13.4.2001 | Për organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e Komitetit të Lojërave të Fatit.....  | 605 |
| Vendim i KM<br>nr.240, datë 13.4.2001 | Për ndarjen e të ardhurave, që rrjedhin nga ushtrimi i veprimtarisë nga subjektet e licencuara për lojëra fati, kazino dhe hipodrome.....          | 606 |

|                                       |   |     |
|---------------------------------------|---|-----|
| Vendim i KM<br>nr.241, datë 20.4.2001 | Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tri Urat-Çarshovë”, në territorin e qarkut të Përmetit.....  | 607 |
| Vendim i KM<br>nr.243, datë 20.4.2001 | Për detyrimin e lëshimit të kuponave tatimorë, me anë të arkave regjistruese.....   | 609 |
| Vendim i KM<br>nr.244, datë 20.4.2001 | Për masën e pagesës për përjashtimin nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv, si dhe për trajtimin e ushtarëve me pagesë.....   | 609 |
| Vendim i KM<br>nr.255, datë 20.4.2001 | Për disa ndryshime në vendimin 225, datë 19.5.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për tarifat e regjistrimit dhe pagesat e verifikimit e të kalibrimit, fillestar ose periodik, të mjeteve matëse”, të ndryshuar me vendimin nr.268, datë 19.6.1997, të Këshillit të Ministrave..... | 610 |
| Vendim i KM<br>nr.272, datë 27.4.2001 | Për miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, për vitin 2001.....  | 613 |
| Vendim i GjK<br>nr.17, datë 4.4.2001  | Me objekt: “Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.276, datë 7.10.1999, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.437, datë 26.10.2000, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë”.....   | 614 |
| Vendim i GjK<br>nr.23, datë 23.4.2001 | Me objekt: “Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.59, datë 15.7.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, nr.153, datë 21.12.1998, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.96, datë 24.2.2000, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë”.....                                     | 617 |
| Vendim i GjK<br>nr.24, datë 24.4.2001 | Me objekt: “Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.322, datë 6.10.2000, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë”.....  | 619 |
| Vendim i GjK<br>nr.25, datë 24.4.2001 | Me objekt: “Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.328, datë 6.10.2000, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (nenet 33/1, 42/1 dhe 131/f të Kushtetutës)”.....  | 621 |
| Vendim i GjK<br>nr.26, datë 24.4.2001 | Me objekt: “Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të pikës 1 shkronja “c” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.19, datë 18.3.2000”.....  | 624 |
| Vendim i GjK<br>nr.27, datë 27.4.2001 | Me objekt: ”Interpretimi i pikës 1 të nenit 12 të Kushtetutës”.....   | 629 |
| Vendim i GJL<br>nr.1, datë 15.2.2001  | Me objekt: “Vjedhje me armë në bashkëpunim, armëmbajtje pa leje, parashikuar nga nenet 140-25 dhe 278/2 të Kodit Penal.....   | 630 |
| Vendim i GjL<br>nr.14, datë 16.2.2001 | Me objekt: “Detyrim kthim sendi, salle bilardoje, korridori e llozhe përreth saj dhe një autoveturë “Audi”  | 635 |

|  |  |     |
|--|--|-----|
| Udhëzim i KQZ<br>nr.25, datë 23.4.2001       | Për mënyrën e ngritjes se qendrave të rishikimit të listave të zgjedhësve dhe grupeve treshe të verifikimit... | 641 |
| Vendim i KKRT<br>nr.41/1, datë 16.4.2001     | Për dhënie licence.....  | 642 |
| Vendim i Gj Kurbin<br>nr.136, datë 12.5.2000 | Për emërim kujdestari.....   | 642 |
| Vendim Gj Pogradec<br>nr.249, datë 23.5.200  | Për caktim kujdestari.....   | 643 |
| Vendimi Gj Dibër<br>nr.98, datë 9.4.2001     | Për shpallje të zhdukur të Gjyzel Esheref Fida.....  | 643 |
| Vendim Gj Dibër<br>nr.102, datë 10.4.2001    | Për shpallje të zhdukur të Atli Abdulla Hakorja.....   | 643 |
| Kërkesë                                      | Për shpallje të zhdukur të Kujtim Skënderaj.....   | 643 |

**V E N D I M**  
**Nr.219, datë 13.4.2001**

**PËR SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLAVE TË QARKUT, TË BASHKISË, TË NJËSIVE BASHKIAKE TË TIRANËS, TË KOMUNAVE DHE TË KRYETARËVE TË FSHATRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 29, të pikës 5 të nenit 46, të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.8654, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e bashkisë së Tiranës”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Anëtarët e këshillave të qarkut, të bashkisë, të njësive bashkiake të Tiranës, të komunave dhe kryetarëve të fshatrave, që punojnë në institucionet dhe ndërmarrjet buxhetore, për ditët që marrin pjesë në mbledhje, nuk marrin shpërblim, por u jepet paga ditore nga qendra e punës, kurse këshilltarët e tjerë dhe kryetarët e fshatrave shpërblehen nga këshilli përkatës, sipas përcaktimeve që bën ky këshill, në masën jo më shumë se paga bazë ditore, sipas klasës XIII dhe, jo më pak se paga bazë ditore, sipas klasës IV të lidhjes II të vendimit nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.

2. Këshilltarët, për veprimtarinë që kryejnë, shpërblehen për çdo muaj si më poshtë vijon:

a) Anëtarët e këshillit të qarkut 5 për qind, anëtarët e këshillave të bashkisë, të njësive bashkiake të Tiranës, të komunës, si dhe anëtarët e kryesisë së këshillit të qarkut, 10 për qind të pagës bazë, mujore, të kryetarit të qarkut, të bashkisë, të njësive bashkiake dhe të komunës përkatëse.

b) Kryetarët e këshillit të bashkisë, të njësisë bashkiake të Tiranës dhe të komunës me 15 për qind të pagës bazë mujore të kryetarit të bashkisë, të kryetarit të njësisë bashkiake të Tiranës ose të komunës.

c) Kryetari i fshatit me më pak se 500 banorë, 10 për qind, me 501-1 500 banorë, 15 për qind dhe me mbi 1500 banorë, 20 për qind të pagës bazë, mujore, sipas klasës XIII të lidhjes II, të vendimit nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.

3. Për efekt dietash, niveli i pagës për anëtarët e këshillave të qarqeve, të bashkive, të njësive bashkiake, të komunave, kryetarëve të këshillave të bashkive, të njësive bashkiake të Tiranës, të komunave dhe të kryetarëve të fshatit, të cilët janë me punë private, do të jetë i barabartë me pagën e tyre sipas klasës XIII, të lidhjes II, të vendimit nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.

4. Vendimi nr.153, datë 5.4.1994, i Këshillit të Ministrave, “Për shpërblimin e anëtarëve të këshillit të rrethit, bashkisë, komunave dhe kryepleqve të fshatrave” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 228, datë 13.4.2001**

**PËR DIETAT E NËPUNËSVE QË DËRGOHEN ME SHËRBIM JASHTË VENDBANIMIT  
TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Punonjësit e ndërmarrjeve dhe të institucioneve, që financohen nga buxheti, kur shkojnë me shërbim jashtë qendrës së tyre të punës dhe nuk kthehen brenda ditës në vendbanimet e tyre, përfitojnë dietë në masën 10 për qind të pagës mujore, por pa kaluar 2000 (dy mijë) lekë në ditë dhe jo më pak se 1000 (një mijë) lekë në ditë. Shpenzimet e fjetjes paguhen sipas dokumenteve të paraqitura, që e vërtetojnë atë, por jo më shumë se 2000 lekë për çdo natë të fjetur. Shpenzimet e udhëtimit paguhen sipas vleftës së biletës së udhëtimit me transport hekurudhor, automobilistik dhe ujqor. Kur udhëtimi bëhet me taksi apo furgona, shpenzimet e udhëtimit paguhen sipas çmimeve të miratuara për linjën përkatëse me tren, autobus ose anije, plus 25 për qind të çmimit të biletës së transportit të linjës me autobus, dhe kur nuk ka linjë autobusi të trenit apo të anijes.

2. Dërgimi me shërbim jashtë rrethit ku banon nëpunësi dhe ku ka qendrën e punës, bëhet me autorizim të titullarit të institucionit ose të zëvendësit të autorizuar prej tij. Në autorizim përcaktohet koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij.

3. Për efekt të llogaritjes së dietës, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten bashkarisht, një ditë e plotë.

4. Personave, që nuk janë në marrëdhënie pune dhe dërgohen me shërbim, dieta u paguhet nga urdhëruesi i shërbimit, në masën 1 400 (një mijë e katërqind) lekë në ditë, si dhe shpenzimet e tjera, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

5. Punonjësit e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, kur shkojnë me shërbim jashtë qendrës së tyre të punës, për rastet kur përfitojnë dietë dhe kthehen brenda ditës, jashtë kohës normale të punës, përfitojnë dietë në masën 600 (gjashtëqind) lekë në ditë.

6. Nuk paguhet dietë kur shërbimi kryhet në qendrat dhe fshatrat që janë afër qyteteve ose qendrave të punës, në vendet ku ka shërbim transporti të vazhdueshëm dhe që përcaktohen me vendim të këshillit të qarkut.

7. Studentëve universitarë, parauniversitarë dhe nxënësve e kursantëve të shkollave të ndryshme, me ose pa bursë, kur dërgohen me shërbime të ndryshme: si praktika mësimore, ekspozita, shërbime me karakter mësimor etj. u paguhet dietë në masën 900 (nëntëqind) lekë në ditë.

Nxënësve dhe studentëve me bursë dhe gjysmë apo gjysëm bursë, për kohën që marrin dietë, u ndërpritet bursa për ushqim.

Trajtimi ushqimor i nxënësve dhe i studentëve, që gjatë kohës së praktikave mësimore nuk marrin dietë, por sistemohen në konvikte me mensë, të jetë në masën që ka konvikti përkatës, ku kryhet shërbimi.

8. Sportistët, trajnerët, gjyqtarët sportivë jovendas, për veprimtaritë, që zhvillohen ndërmjet rretheve, përfitojnë dietë, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Sportistët, trajnerët, gjyqtarët sportivë jovendas, për veprimtaritë sportive që zhvillohen brenda rrethit, përfitojnë dietë në masën 600 (gjashtëqind) lekë në ditë, si dhe shpenzimet e udhëtimit për rastet kur u takon dietë. Sportistët e zonave të largëta, që nuk mund të kthehen brenda ditës, përfitojnë dietë në masën 700 (shtatëqind) lekë në ditë, si dhe shpenzimet e udhëtimit dhe të fjetjes.

Çiklistët për garat më të gjata se 50 km, vozitësit për garat më të gjata se 5 km, notarët, peshëngritësit, maratonistët dhe alpinistët gjatë ditëve të veprimtarive sportive marrin, përveç dietës, edhe një shtesë prej 400 (katërqind) lekësh në ditë.

9. Artistët e institucioneve kulturoro-artistike, kur shkojnë me shërbim për dhënie shfaqjesh jashtë rrethit, përfitojnë dietë në masën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

Për veprimtaritë kulturore me sistem grumbullimi, për konkurim olimpiade, festival filmash dhe teatro profesioniste, masa e dietës të jetë 2000 ( dy mijë) lekë në ditë, për rastet kur u takon dietë, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

10. Prefektët e qarkut që kryejnë funksione larg vendbanimeve të tyre, për sa kohë që nuk u janë siguruar kushtet për të marrë familjen me banim pranë vendit të punës, përfitojnë dietë dhe u paguhen shpenzimet e fjetjes sipas pikës 1 të këtij vendimi.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxhetet e institucioneve përkatëse, të miratuara për vitin 2001.

12. Vendimi nr. 549, datë 7.11.1994, i Këshillit të Ministrave, “Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre”, si dhe vendimi nr. 320, datë 23.5.1998 i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 549, datë 7.11.1994, të Këshillit të Ministrave , “Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre”, si dhe çdo vendim apo akt tjetër, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

13. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 238, datë 13.4.2001**

**PËR KRITERET E DHËNIES SË LEJES PËR LOJËRAT E FATIT, KAZINOTË DHE HIPODROMET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6,13,15 dhe 24, të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

**I. KRITERET PËR DHËNIEN E LEJES PËR LOJËRAT E FATIT**

1. Sipas propozimit të Komitetit të Lojërave të Fatit, në kuptim të nenit 3 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet” Ministri i Financave i jep lejen organizatorit, për një periudhë kohe 10- vjeçare. Për dhënie e lejes për lojërat e fatit, duhet të plotësohen këto kushte:

a) Shoqëria përkatëse të jetë regjistruar në regjistrin tregtar, në formën e shoqërisë anonime, me objekt veprimtarie zhvillimin e lojërave të fatit, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) Të deklarohen themeluesit e shoqërisë, drejtuesit dhe personeli kryesor i saj.

c) Organizatori duhet të sigurojë, në çdo lojë fati, një person drejtues e kontrollues me kualifikimin dhe përvojën e nevojshme. Për këtë qëllim, në kërkesat që paraqiten në Ministrinë e Financave, duhet të vërtetohet kualifikimi i tyre.

ç) Organizatori duhet të garantojë, për çdo lojë, fituesin/fituesit e lojërave të fatit. Me qëllim, krijimin e garancive për fituesit e lojërave të fatit, organizatori është i detyruar të ngurtësojë një shumë të caktuar, mënyra, forma dhe masa e së cilës, përcaktohen në lejen e dhënë organizatorit të lojës. Kjo shumë ngurtësohet në një llogari të veçantë bankare dhe zhbllkohet, vetëm me urdhër të Ministrit të Financave, sipas propozimit të Komitetit të Lojërave të Fatit. Komiteti i propozon Ministrit të financave zhbllokimin e këtij fondi, vetëm, pasi ka marrë ripohimin, me shkrim, të organeve tatimore, për shlyerjen e detyrimeve nga organizatori.

d) Për pajisjet dhe teknologjinë e nevojshme për zhvillimin e lojërave, organizatori i lojërave të fatit, është i detyruar të depozitojë, në Komitetin e lojërave të fatit, certifikatën përkatëse të lëshuar nga Insituti i Metrologjisë.

dh) Organizatori duhet të paraqesë, në Komitetin e Lojërave të Fatit, kushtet dhe rregullat e mënyrës së funksionimit të zhvillimit të lojërave, të pasqyruara këto, në rregulloren përkatëse.

2. Organizatori i lojërave të fatit mund ta ushtrojë veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ai është i detyruar të marrë leje, nga Ministri i Financave, për çdo filial ku do të ushtrohet veprimtaria.

## II. KRITERET PËR DHËNIEN E LEJES PËR KAZINOTË

1. Sipas propozimit të Komitetit të Lojërave të Fatit, Ministri i Financave i jep lejen organizatorit të kazinosë, për një periudhë kohe 15-vjeçare. Për dhënien e lejes për kazino, duhet të plotësohen këto kushte:

a) Shoqëria përkatëse të jetë regjistruar në regjistrin tregtar, në formën e shoqërisë anonime. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë, duhet të jetë vetëm, veprimtaria e kazinosë dhe e lojërave të fatit.

b) Organizatori duhet të garantojë, në çdo rast, fituesit. Për këtë qëllim, ai duhet të ngurtësojë një shumë prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, për garantimin, në çdo rast të fituesve. Kjo shumë ngurtësohet në një llogari të veçantë bankare dhe zhbllkohet, vetëm me urdhër të Ministrit të Financave, sipas propozimit të Komitetit të Lojërave të Fatit. Komiteti i propozon Ministrit të Financave zhbllokimin e këtij fondi, vetëm pasi ka marrë ripohimin me shkrim, të organeve tatimore, për shlyerjen e detyrimeve nga organizatori.

c) Të deklarohen themeluesit e shoqërisë, ortakët, drejtuesit dhe personeli.

Personat e përmendur më sipër, nuk duhet të jenë të dënuar më parë personalisht, për vepra penale në fushën e kimit ekonomik, për të cilat parashikohet dënim me burg.

ç) Organizatori duhet të sigurojë personel të kualifikuar në fushën e kazinove. Për këtë qëllim, organizatori duhet ta vërtetojë një fakt të tillë, në kërkesën drejtuar Komitetit të Lojërave të Fatit.

2. Organizatori duhet të paraqesë, në Komitein e Lojërave të Fatit, kushtet dhe rregullat e mënyrës së funksionimit të lojës në kazino, duke depozituar në këtë rast, rregulloret përkatëse.

## III KRITERET PËR DHËNIEN E LEJES PËR HIPODROMET

1. Sipas propozimit të Komitetit të Lojërave të Fatit, Ministri i Financave i jep lejen organizatorit të hipodromit, për një periudhë kohe 15-vjeçare. Për dhënien e lejes për hipodrom, duhet të plotësohen këto kushte :

a) Shoqëria duhet të regjistrohet në regjistrin tregtar, në formën e shoqërisë anonime. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë duhet të jetë, vetëm veprimtaria e hipodromit dhe e lojërave të fatit.

b) Organizatori duhet të garantojë, në çdo rast, fituesit. Për këtë qëllim, ai duhet të ngurtësojë një shumë prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milion ) lekësh, për garantimin në çdo rast, të fituesve. Kjo shumë ngurtësohet në një llogari të veçantë bankare dhe zhbllkohet vetëm, me urdhër të Ministrit të Financave, sipas propozimit të Komitetit të Lojërave të fatit. Komiteti i propozon Ministrit të Financave zhbllokimin e këtij fondi, vetëm pasi ka marrë ripohimin, me shkrim, të organeve tatimore, për shlyerjen nga organizatori.

c) Të deklarohen themeluesit e shoqërisë, ortakët, drejtuesit dhe personeli.

ç) Organizatori duhet të sigurojë personel të kualifikuar në fushën e hipodromeve. Për këtë qëllim, organizatori duhet ta vërtetojë një fakt të tillë, në kërkesën drejtuar Komitetit të Lojërave të Fatit.

2. Organizatori duhet të paraqesë, në Komitetin e Lojërave të Fatit, kushtet dhe rregullat e mënyrës së funksionimit të lojës në hipodrom, duke depozituar në këtë rast, rregulloret përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**V E N D I M**  
**Nr.239, datë 13.4.2001**

**PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE PËRGJEGJËSITË E KOMITETIT TË  
LOJËRAVE TË FATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Komiteti i Lojërave të Fatit, që më poshtë do të quhet “Komiteti”, organizohet si drejtori, në varësi të Ministrisë së Financave.

2. Struktura organizative e komitetit është si më poshtë vijon:

Drejtori;

Spektori për lojërat e fatit;

Spektori për kazinotë;

Spektori për hipodromet;

3. Numri i specialistëve, në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, përcaktohet nga Ministri i Financave.

4. Pagat e punonjësve të Komitetit të Lojërave të Fatit, caktohen në mbështetje të vendimit nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”. Paga e Drejtorit të Komitetit të Lojërave të Fatit të jetë, sipas klasifikimit “B3”, të lidhjes I “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”, ndërsa pagat e punonjësve të tjerë të jenë sipas lidhjes II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”.

5. Komiteti i Lojërave të Fatit ushtron përgjegjësitë e mëposhtme:

Shqyrton kërkesat e subjekteve të ndryshme për licencimin e lojërave të fatit, si dhe ato që vijnë nga organet e qeverisjes vendore, sipas pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, dhe ia paraqet ato për miratim përfundimtar, sipas ligjit, Ministrit të Financave.

Organizon punën dhe përgatit aktet e nevojshme, ligjore dhe nënligjore, në fushën e lojërave të fatit, të kazinove dhe hipodromeve.

I propozon Ministrit të Financave kandidaturat për caktimin e personave në rolin e mbikëqyrësit, pranë subjekteve të licencuara për veprimtaritë, sipas ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”.

I propozon Ministrit të Financave standardet dhe format e biletave të lojërave të fatit, pasi të ketë marrë edhe mendimin e organizatorit. Ministri i Financave ka autoritetin e miratimit të tyre.

Në bashkëpunim me subjektet e licencuara, merr masat për shtypjen e biletave, duke ushtruar kontroll dhe mbikëqyrje në këtë proces, sidomos në shpërndarjen e këtyre biletave, subjekteve të licencuara, duke mbajtur regjistrimet përkatëse për secilin prej tyre.

Organeve të qeverisjes vendore t’i dërgohet dokumenti i miratimit paraprak të lejeve, për ushtrimin e veprimtarive të lojërave të fatit, të kompetencës së tyre.

Ushtron kontroll dhe mbikëqyr veprimtarinë e subjekteve të licencuara dhe, kur vëren shkelje, i propozon Ministrit të Financave marrjen e masave, sipas ligjit. Në ushtrimin e kësaj përgjegjësie ai ka të drejtë të bashkëpunojë me organet tatimore dhe të kërkojë nga ato, të dhëna për shlyerjen e detyrimeve nga subjektet e licencuara dhe ushtrimin e kontrolleve, të vazhdueshme, në



këto veprimtari. Organet tatimore, në këto raste, duhet të japin të dhënat e kërkuara nga Komiteti.

Njofton, zyrtarisht, organet tatimore për të gjitha subjektet e licencuara për lojëra fati, kazino dhe hipodrome. Njoftimi jepet brenda 5 ditëve, nga marrja e lejes për ushtrimin e këtyre veprimtarive. Gjithashtu, Komiteti vë në dispozicion të organeve tatimore, sipas kërkesës së tyre, të gjithë dokumentacionin që zotëron për organizatorët dhe veprimtarinë e tyre.

I kërkon organit tatimor ose organeve të tjera shtetërore, të bëjnë mbylljen e veprimtarive në ato subjekte, të cilët janë të palicencuara ose kur ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi.

Ushtron edhe të gjitha përgjegjësitë e tjera, të dhëna me ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”

**KRYEMINISTRI**

**Ilir Meta**

## **V E N D I M**

**Nr. 240, datë 13.4.2001**

### **PËR NDARJEN E TË ARDHURAVE, QË RRJEDHIN NGA USHTRIMI I VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET E LICENCUARA PËR LOJËRA FATI, KAZINO DHE HIPODROME.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 22 dhe 25 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

#### **V E N D O S I:**

1. Ndarja e të ardhurave për organizatorin dhe fituesit nga lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet, bëhet pasi nga totali i qarkullimit të realizuar, të zbriten më parë tatimi mbi vlerën e shtuar dhe tatimi mbi lojërat e fatit.

Tatimi mbi vlerën e shtuar llogaritet duke pjesëtuar “qarkullimin gjithsej”, (të ardhurat) me shifrën 6. Pjesa që mbetet pas zbritjes së tatimit mbi vlerën e shtuar përbën “qarkullimin” (të ardhurat pa tatimin mbi vlerën e shtuar).

Tatimi mbi lojërat e fatit llogaritet duke pjesëtuar “qarkullimin” (të ardhurat pa tatimin mbi vlerën e shtuar) me shifrën 6. Pjesa që mbetet pas zbritjes së tatimit mbi lojërat e fatit, ndahet ndërmjet organizatorit dhe fituesit.

2. Ndarja e të ardhurave nga lojërat e fatit, pasi më parë janë zbritur detyrimet tatimore (tatimi mbi vlerën e shtuar dhe tatimi mbi lojërat e fatit), sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet si vijon:

Për lojërat aritmetike:

60 për qind e të ardhurave që mbeten, i jepen fituesit/fituesve të lojës;

40 për qind e të ardhurave që mbeten, i merr organizatori i lojës, pra subjekti i licencuar.

Për lojërat sportive:

60 për qind e të ardhurave që mbeten, i jepen fituesit/fituesve të lojës;

40 për qind e të ardhurave që mbeten, i merr organizatori i lojës. Një pjesë e të ardhurave të organizatorit shkon në favor të fondit kombëtar të zhvillimit të sportit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas propozimit të ministrit përkatës, dhe duke u përcaktuar në lejen që i jepet organizatorit.

Për llotaritë:

60 për qind e të ardhurave që mbeten, i jepen fituesit/fituesve të lojës;

40 për qind e të ardhurave që mbeten, i merr organizatori i lojës.

Për lojërat elektronike:

- 50 për qind e të ardhurave që mbeten, i jepen fituesit/fituesve të lojës;  
50 për qind e të ardhurave që mbeten, i merr organizatori i lojës.  
Ndarja e të ardhurave për lojërat e fatit, që organizohen nga Kryqi i Kuq Shqiptar, pasi më parë janë zbritur detyrimet tatimore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet si vijon:  
50 për qind e të ardhurave që mbeten, i jepen fituesit/fituesve të lojës;  
50 për qind e të ardhurave që mbeten, i merr organizatori i lojës.  
3. Ndarja e të ardhurave nga kazinotë, pasi më parë janë zbritur detyrimet tatimore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet si vijon:  
60 për qind e të ardhurave që mbeten, i jepen fituesit për çdo lojë në kazino;  
40 për qind e të ardhurave që mbeten, i merr organizatori, subjekt i licencuar për ushtrimin e veprimtarisë në kazino.  
4. Ndarja e të ardhurave nga hipodromet, pasi më parë janë zbritur detyrimet tatimore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet si vijon:  
60 për qind e të ardhurave që mbeten, i jepen fituesit për çdo lojë në hipodrom;  
40 për qind e të ardhurave që mbeten, i merr organizatori, subjekt i licencuar për ushtrimin e veprimtarisë në hipodrom.  
5. Në rastet e parashikuara në pikën 5 të nenit 13 dhe në pikën 6 të nenit 23 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000, për organizatorin e lojës detyrimet për të ardhurat e realizuara do të jenë të njëjta me atë të përcaktuar për organizatorët e tjerë, që kanë si objekt veprimtarie ushtrimin e lojërave elektronike, të fatit, me fitim në çast.  
6. Këshilli i Ministrave ka autoritetin dhe mund të rishikojë raportin e ndarjes së të ardhurave, ndërmjet organizatorit dhe fituesit për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**V E N D I M**  
**Nr. 241, datë 20.4.2001**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “TRI URAT-ÇARSHOVË”, NË TERRITORIN E QARKUT TË PËRMETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5, të neneve 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, të pronave, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tri Urat Çarshovë”, në territorin e qarkut të Përmetit.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe të përgjithshme 3 296 m<sup>2</sup>, vlerësuar në shumën e përgjithshme 2 352 700 (dy milionë e treqind e pesëdhjetë e dymijë e shtatëqind) lekësh.
4. Fondi për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2001, në zërin “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit.

5. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.5.2001.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

Listat e pronarëve që shpronësohen për efekt të ndërtimit  
rë segmentit rrugor Tre Urat - Çarshovë

**RRETHI PËRMET / KOMUNA ÇARSHOVË**  
bujqësore nr. (1-7)

Lloji i pasurisë së paluajtshme, tokë

| Nr | Emër Atësi Mbiemër    | Nr.i aktit | Nr i parcelës | Sip./m2 | Çmimi lek/m2 | Totali në lek |
|----|-----------------------|------------|---------------|---------|--------------|---------------|
| 1. | Thanas Vasil Drasa    | 3030       | 224/25        | 96      | 700          | 67200         |
| 2. | Dhimitër Thanas Drasa | 3021       | 224/27        | 87      | 700          | 60900         |
| 3. | Dhionis Vasil Kobuzi  | 3072       | 224/27        | 435     | 700          | 304500        |
| 4. | Apostol Llazo Drasa   | 3076       | 222/1         | 749     | 700          | 524300        |
| 5. | Ilia Apostol Drasa    | 3076       | 222/2         | 517     | 700          | 361900        |
| 6. | Pano Foti Bitika      | 3057       | 222/3         | 411     | 700          | 287700        |
| 7. | Ali Myrteza Myrtolli  | 3727       | 64/4          | 30      | 700          | 21000         |
|    | Shuma                 |            |               | 2325    |              | 1.627.500     |

Lloji i pasurisë së paluajtshme, tokë bujqësore Nr.1

| Nr | Emër Atësi Mbiemër | Nr.i aktit | Nr i parcelës | Sip./m2 | Çmimi lek/m2 | Totali në lek |
|----|--------------------|------------|---------------|---------|--------------|---------------|
| 1. | Konflikt           |            | 222/4         | 971     | 700          | 679700        |
|    | Shuma              |            |               | 971     |              | 679700        |

**MINISTRIA E TRANSPORTIT**  
Shpenzime publikimi 45 500 lekë

**V E N D I M**  
**Nr. 243, datë 20.4.2001**

**PËR DETYRIMIN E LËSHIMIT TË KUPONAVE TATIMORË, ME ANË TË ARKAVE  
REGJISTRUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.7758, datë 12.10.1993 “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”, të ndryshuar me ligjet nr.7900, datë 8.12.1995 dhe nr.8147, datë 11.9.1996, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Tatimpaguesit, të cilët shesin mallra dhe prodhime, apo kryejnë furnizime a shërbime në lokale apo njësi fikse të hapura për publikun, detyrohen të vendosin arka regjistruese, për lëshimin e kuponave tatimorë, për sa më sipër.

2. Sigurimi i arkave regjistruese bëhet nga vetë subjektet, që janë të detyruara të pajisen me to. Ministri i Financave, me udhëzim, përcakton karakteristikat dhe treguesit e domosdoshëm, që duhet të ketë arka regjistruese. Shërbimi i vendosjes së arkave regjistruese në njësi, sigurohet nga vetë tatimpaguesit.

3. Tatimpaguesit janë të detyruar të përdorin arkën regjistruese, në mënyrë të vazhdueshme. Në rast defekti, riparimi i arkave regjistruese sigurohet nga vetë tatimpaguesit. Gjatë kohës që arka regjistruese është në riparim apo nuk është në gjendje pune, tatimpaguesit evidentojnë qarkullimin e realizuar nëpërmjet dëftesës tatimore.

4. Tatimpaguesit, që kanë vendosur në njësi arka regjistruese, janë të detyruar të lëshojnë, për çdo rast, kuponin tatimor për shitjen e mallrave apo kryerjen e shërbimeve ndaj klientëve.

5. Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari ambulante, profesione të lira dhe kanë njësi artizanale, nuk janë të detyruar të vendosin arkë regjistruese dhe të evidentojnë të ardhurat nëpërmjet saj. Ministri i Financave, me udhëzim, detajon të gjitha llojet e veprimtarive të përmendura më sipër.

6. Afati përfundimtar i pajisjes së njësive të tatimpaguesve me arka regjistruese është data 1 tetor 2001.

7. Ndaj tatimpaguesve, të cilët janë të detyruar të vendosin dhe të përdorin arkën regjistruese dhe nuk e kanë vendosur atë, deri më 30 qershor 2001, pas kësaj date merren masa administrative, sipas ligjit nr.7758, datë 12.10.1993 “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”, ndryshuar me ligjet nr.7900, datë 8.12.1995 dhe nr.8147, datë 11.9.1996.

8. Ministri i Financave nxjerr udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

9. Vendimi nr.43, datë 14.2.1994, i Këshillit të Ministrave, “Për detyrimin e personave fizikë dhe juridikë, për t’u pajisur me arka regjistruese” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 244 datë 20.4.2001**

**PËR MASËN E PAGESËS PËR PËRJASHTIMIN NGA SHËRBIMI I DETYRUESHËM  
USHTARAK AKTIV, SI DHE PËR TRAJTIMIN E USHTARËVE ME PAGESË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.7978, datë 26.7.1995 “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 6 dhe 35, të ligjit nr. 8670, datë

26.10.2000 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shtetasit shqiptarë, që janë të aftë dhe janë brenda moshës për kryerjen e shërbimit ushtarak aktiv, mund të përjashtohen nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak, në rast se ata paguajnë njëherësh, një shumë prej 300 000 (treqind mijë) lekësh.

2. Ushtari, me pagesë, trajtohet me pagën bazë të nivelit më të ulët të pagës së ushtarakut, shtesë për vjetërsi shërbimi, shpërblim për gradën, si dhe deri në 50 për qind shtesë mbi pagën bazë, për vështirësi vendi e shërbimi.

Shkallëzimi i kësaj shtese bëhet nga Ministri i Mbrojtjes.

3. Ushtari me pagesë përfiton trajtimin me ushqim pa pagesë, uniformën, sipas normës së nënoficerit, dhe pushimin vjetor, të paguar prej 20 ditësh.

4. Nga të ardhurat që përfitohet sipas këtij vendimi, 90 për qind t’i kalojnë Ministrisë së Mbrojtjes dhe 10 për qind t’i kalojnë buxhetit të shtetit.

5. Ministria e Mbrojtjes nxjerr aktet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

vendimi nr.57, datë 2.2.1996, i Këshillit të Ministrave, “Për disa të drejta e detyra që rrjedhin nga ligji nr. 7978, datë 26.7.1995 “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me vendimin nr.548, datë 28.8.1998, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M

NR.255, DATË 20.4.2001

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.225, DATË 19.5.1993, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ”PËR TARIFAT E REGJISTRIMIT DHE PAGESAT E VERIFIKIMIT E TË KALIBRIMIT, FILLESTAR OSE PERIODIK, TË MJETEVE MATËSE”, TË NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.268, DATË 19.6.1997, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr. 7625, datë 20.10.1992 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pasqyrën nr.2, që i bashkëlidhet vendimit nr.225, datë 19.5.1993, bëhen këto ndryshime:

I. Pas pikës 13, shtohet pika 14, me këtë përmbajtje:

“ 14. Instrumentet matës të rrezatimeve jonizuese.

14.1. Aparatet radiodiagnostikuese

|                       |             |
|-----------------------|-------------|
| a) Radiografi         | 10 000 lekë |
| b) Radioskopi         | 10 000 lekë |
| c) Fluoroskopi        | 10 000 lekë |
| ç) Mammografi         | 10 000 lekë |
| d) Radiografi dentare | 10 000 lekë |

#### 14.2. Dozimetrat

|                                |            |
|--------------------------------|------------|
| a) Dozimetrat radiodiagnostikë | 7 000 lekë |
| b) Dozimetrat radioterapikë    | 7 000 lekë |

#### 14.3. Të tjera

|                         |            |
|-------------------------|------------|
| a) Radiometrat          | 4 000 lekë |
| b) Monitorët            | 4 000 lekë |
| c) Indikatorët portabël | 4 000 lekë |

II. Pikat 14 dhe 15 të pasqyrës së mëparshme marrin në pasqyrën e re, respektivisht, numrat 15 dhe 16.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

Analiza e kostos për kalibrimin dhe verifikimin fillestar a periodik të dozimetrave radioterapeutike radiodiagnostike.

#### **PËRBËRËSIT E ANALIZËS SË KOSTOS**

- Koha e punës, e nevojshme për verifikim 11 orë

|  |                |
|--|----------------|
| - Koha për vajtje ardhje në subjekt                  | 1 orë e 30 min |
| - Koha për mbushje dokumentacioni                    | 30 min         |
| - Koha për verifikim praktik                         |                |
| - Kontrolli i gjendjes së përgjithshme dhe ambientit | 30 min         |
| - Hetimi i stabilitetit                              | 1 orë          |
| - Koha e jehonës dhe nxehjes së plotë                | 1 orë          |
| - Vendosija e zeros                                  | 30 min         |
| - Matjet e efektit të rrjedhjes                      | 1 orë          |
| - Vendosija dhe orientimi i kamerës etalon           | 1 orë          |
| - Matjet direkte                                     | 2 orë          |
| - Korrigjimet e matjeve                              | 1 orë          |
| - Llogaritja e pasigurisë                            | 2 orë          |

|  |            |
|--|------------|
| 1. Shpenzime për pagesën e inspektorit<br>200 paga orare x 11 orë x 2 inspektorë | 4400 lekë  |
| 2. Shpenzime amortizimi bazës etalonuese   | 1500       |
| - amortizimi i etaloneve të përdorur   | 500 lekë   |
| - shpenzime verifikimi bazës etalonuese  | 1000 lekë  |
| 3. Shpenzime të automjetit   | 202 lekë   |
| - karburant 12 litra x 90 lek/litri x 15 km                                      | 162 lekë   |
| - amortizimi orar i automjetit   | 40 lekë    |
| 4. Shpenzime për bazë materiale dhe lëndë të para                                | 100 lekë   |
| - energji elektrike 100 lekë   |            |
| shuma =  | 62 20 lekë |
| 5. Shpenzime administrative  |            |

|   |           |
|---|-----------|
| 20 % e shumës                                 | 1200 lekë |
| Çmimi real (shumë + shpenzime administrative) | 7420 lekë |
| Çmimi i pranuar                               | 7000 lekë |

Analiza e koston për verifikimin dhe kalibrimin fillestar apo periodik të radiometrave, monitorëve dhe indikatorëve portabël të rrezatimeve X dhe gama

|  |              |
|--|--------------|
| Përbërësit e analizës së koston                                    |              |
| Koha e punës, e nevojshme për verifikim                            | 7 orë 30 min |
| - Koha për vajtje- ardhje në subjekt                               | 1 orë 30 min |
| -Koha për mbushje dokumentacioni                                   | 30 min       |
| - Koha për verifikim praktik                                       |              |
| - Kontrolli i gjendjes së përgjithshme dhe ambientit               | 30 min       |
| - Kontrolli i funksionimit të rregullt                             | 1 orë        |
| - Kontrolli për kalibrimin   |              |
| - Verifikimi i saktësisë së përgjigjes ndaj rrezatimit të zgjedhur | 30 min       |
| - Verifikimi i pragut të alarmit                                   | 30 min       |
| - Varësia energjitike  | 1 orë        |
| - Fluktacionet energjitike   | 30 min       |
| - Koha e përgjigjes  | 30 min       |
| - Mbingarkesa  | 1 orë        |

|  |           |
|--|-----------|
| 1. Shpenzime për pagesën e inspektorit             |           |
| 200 paga orare x 7,5 orë x 1 inspektorë            | 1500 lekë |
| 2. Shpenzime amortizimi bazës etalonuese           | 1500 lekë |
| -amortizimi i etalonëve të përdorur                | 500 lekë  |
| - shpenzime verifikimi bazës etalonuese            | 1000 lekë |
| 3. Shpenzime të automjetit                         | 202 lekë  |
| -karburant 12 litra x90 lek/litri x 15 km          | 162 lekë  |
| -amortizimi orar i automjetit                      | 40 lekë   |
| 4. Shpenzime për bazë materiale dhe lëndë të para  | 100 lekë  |
| amortizimi i pllakave radioaktiveshuma = 3320 lekë |           |

|  |           |
|--|-----------|
| 5. Shpenzime administrative                    |           |
| 20 % e shumës                                  | 660 lekë  |
| Çmimi real (shumës + shpenzime administrative) | 3980 lekë |
| Çmimi i pranuar                                | 4000 lekë |

Analiza e koston për verifikimin fillestar apo periodik të instalimeve Radiodiagnostikuese  
Përbërësit e analizës së koston

|   |                |
|---|----------------|
| Koha e punës, e nevojshme për verifikim             | 18 orë         |
| - Koha për vajtje ardhje në subjekt                 | 1 orë e 30 min |
| - Koha për mbushje dokumentacioni                   | 30 min         |
| - Koha për verifikim praktik                        |                |
| - Kontrolli i gjendjes së përgjithshme të ambientit | 30 min         |
| - Testimi i varësive të tensionit                   | 3 orë          |
| - Testimi i varësisë së rrymës                      | 3 orë          |
| - Testimi i varësisë së kohës ekspozimit            | 3 orë          |
| - Testimi i varësive të dozës ekspozimit absorbimit | 3 orë e 30 min |
| - Testimi i fuqisë së dozës                         | 3 orë          |

|  |            |
|--|------------|
| 1. Shpenzime për pagesën e inspektorit<br>200 paga orare x 18 orë x 2 inspektorë | 7200 lekë  |
| 2. Shpenzime amortizimi të bazës etalonuese                                      | 1500 lekë  |
| - amortizimi i etaloneve të përdorur   | 500 lekë   |
| -shpenzime verifikimi bazës etalonuese   | 1000 lekë  |
| 3. Shpenzime të automjetit   | 202 lekë   |
| - karburant 12 litra x 90 lek/litri x15 km                                       | 162 lekë   |
| - amortizimi orar i automjetit   | 40 lekë    |
| 4. Shpenzime për bazë materiale dhe lëndë të para                                | 100 lekë   |
| -Bateri elektrike  | 100 lekë   |
| shuma=90020 lekë   |            |
| 5. Shpenzime administrative  |            |
| 20 % e shumës  | 1800 lekë  |
| Çmimi real ( shumë + shpenzime administrative)                                   | 10820 lekë |
| Çmimi i pranuar  | 10000 lekë |

## V E N D I M

Nr. 272, datë 27.4.2001

### PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE, PËR VITIN 2001

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 87 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

#### V E N D O S I:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, për vitin 2001, në shumën 65 000 000 (gjashtëdhjetepesë milionë) lekë, sipas strukturës së paraqitur në lidhjen nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta



**LIDHJA 1**  
**STRUKTURA E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË**  
**TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2001**

| Nr. | EMËRTIMI                           | SHUMA LEKË  |
|-----|------------------------------------|-------------|
|     | Shpenzime gjithsej                 | 65, 000.000 |
| 1   | Shpenzime për paga                 | 9.600.000   |
| 2   | Shpenzime për sigurime shoqërore   | 1.800.000   |
| 3   | Shpenzime për materiale e shërbime | 10.120.000  |
| 4   | Shpenzime për investime            | 43.000.000  |
| 5   | Shpenzime për fond të veçantë      | 480.000     |

**V E N D I M**  
**Nr.17, datë 4.4.2001**

**“NE EMER TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE”**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci, Anëtar i ““

Hajredin Fuga, Anëtar i ““

Alfred Karamuço, Anëtar i ““

Kujtim Puto, Anëtar i ““

Sokol Sadushi, Anëtar i ““

Kristofor Peçi, Anëtar i ““

me sekretare Drita Panda, në datën 9.3.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.15 akti që i përket:

**K E R K U E S:** QERIM FEKOLLARI, i përfaqësuar nga avokatët Kujtim Capo e Vladimir Gërmenji, me prokurë.

**O B J E K T I:**

“Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.276, datë 7.10.1999, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.437, datë 26.10.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë”.

Për shfuqizimin si antikushtetues të këtyre vendimeve kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

1. Kundër vendimit të gjykatës së rrethit ka bërë apel prokurori, por lidhur me këtë akt procedural, ai nuk është vënë në dijeni.

2. Gjykata e Apelit, e ka zhvilluar gjykimin në mungesë të kërkuesit, pa e njoftuar atë sipas ligjit për datën e gjykimit, për më tepër, që ka rënduar pozitën e tij, duke rritur masën e dënimit nga 3 (tre) në 5 (pesë) vjet burgim.

3. Si Gjykata e Apelit, dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nuk i kanë marrë parasysh pretendimet e ngritura në rekurs, kanë zhvilluar një proces ligjor të parregullt në kundërshtim me nenet 31, 42 e 131/f të Kushtetutës.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin zotin Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuessit, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.485, datë 27.7.1999, ndër të tjera, ka vendosur të deklarojë fajtor kërkuessin Qerim Fekollari, për veprën penale të falsifikimit të letrave me vlerë në bashkëpunim dhe, në bazë të neneve 184 e 25 të Kodit Penal, e ka dënuar me 3 (tre) vjet burgim. Gjykata e Apelit Tiranë, që ka shqyrtuar çështjen mbi ankimin e prokurorit, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së faktit, duke e rritur masën e dënimit nga 3 (tre) në 5 (pesë) vjet burgim.

Gjatë gjykimit, Gjykata Kushtetuese konstaton se Gjykata e Apelit Tiranë ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës. Mosvënia e të pandehurit në dijeni të apelit të prokurorit dhe mosnjoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjes, i ka mohuar atij tërësisht të drejtën e mbrojtjes në këtë gjykim. Kështu, ndërsa prokuroria ka paraqitur ankim ndaj vendimit të gjykatës së rrethit, kopja e këtij ankimi nuk i është dërguar kërkuessit sipas mënyrës dhe në vendin e parashikuar nga neni 140 i Kodit të Procedurës Penale për të pandehurin e lirë. Siç del nga lajmërimi bashkëngjitur dosjes, kjo kopje është dërguar në repartin 313 (burg) më datë 06.08.1999, në një kohë që i pandehuri ishte liruar nga ky repart që më datë 18.3.1999 me vendim të gjykatës së rrethit dhe ndodhej në banesën e tij në lagjen “Konferenca e Labinotit” në Elbasan.

Në procesverbalin e seancës gjyqësore datë 7.10.1999, në Gjykatën e Apelit Tiranë, pasqyrohet se kërkuessi Qerim Fekollari ka patur dijeni për datën e gjykimit, por nuk është paraqitur. Lidhur me këtë, në dosje ndodhen dy njoftime, më datë 20.9.1999, njëra drejtuar Kolegjit të Avokatëve (av. Petraç Semani), por që nuk ka konfirmim për marrje dhe tjetra Repartit 313 (burg) Tiranë, për të shoqëruar të pandehurin për gjykim, pra, njoftimi është dërguar në adresë të gabuar, njëlloj si me ankimin e prokurorit. Që ky njoftim është i parregullt, del edhe nga fakti se për të pandehurin tjetër Nehat Ali, njoftimi i është bërë edhe me fletë-thirrje në banesën e tij në lagjen “Luigj Gurakuqi”, Elbasan. Për rrjedhojë, ky i pandehur është përfaqësuar nga avokati i tij në gjykimin e çështjes në apel, ndërsa për kërkuessin gjykimi është zhvilluar në mungesë, pa e njoftuar. Vetë kërkuessi ka bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës së rrethit, duke pretenduar pafajësi, kështu që ai ka qenë i interesuar për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes në gjykatën e apelit, por mungesa e njoftimit ia ka privuar këtë mundësi dhe, për rrjedhim, i është mohuar e drejta e mbrojtjes.

Këto shkelje, të cilat e bëjnë procesin gjyqësor të parregullt, kërkuessi i ka parashtruar në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, por Kolegji Penal, nëpërmjet një arsytimi jo të plotë të vendimit që bie në kundërshtim me faktet dhe rrethanat e dala gjatë gjykimit, nuk e ka pranuar rekursin. Në këtë mënyrë edhe vendimi i Kolegjit Penal, që, në këto kushte, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, është antikushtetues.

Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se, duke mos u njoftuar kërkuessi për ankimin e prokurorit dhe për datën e gjykimit në gjykatën e apelit, atij i janë mohuar njëkohësisht disa të drejta themelore të parashikuara nga Kushtetuta dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, si e drejta për t'u mbrojtur (neni 31/b i Kushtetutës dhe neni 6.3/b i Konventës) dhe e drejta për t'u dëgjuar para se të gjykohet (neni 33 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i Konventës), shkelje këto që e bëjnë procesin gjyqësor të parregullt, sipas nenit 42/1 të Kushtetutës.

### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 31/f të Kushtetutës dhe nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

## V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.437, datë 26.10.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nr.276, datë 7.10.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

### MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër vendimit të shumicës. Kërkesa duhej të rrëzohej për këto shkaqe:

Kërkuesi Qerim Fekollari, ka parashtruar para Gjykatës Kushtetuese, si shkaqe për shpalljen si antikushtetues të vendimeve gjyqësore, faktin se nuk i është komunikuar akti i ankimit të prokurorit, si dhe se nuk është vënë në dijeni për ditën e gjykimit në Gjykatën e Apelit në Tiranë. Këto pretendime janë pranuar nga shumica.

Siç rezulton nga dosja gjyqësore, pretendimet e mësipërme kërkuesi i ka ngritur edhe në rekursin e paraqitur para Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili në lidhje me sa sipër, në vendimin e tij nr.437, datë 26.10.2000, është shprehur tekstualisht se "... i pabazuar është edhe pretendimi i të gjykuarit Qerim Fekollari se nuk ka marrë dijeni për ankimin e prokurorit ...". Sipas po këtij vendimi, edhe për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit, është njoftuar mbrojtësi i të gjykuarit.

Ndodhur në rrethana të tilla, para Gjykatës Kushtetuese shtrohej problemi nëse ajo në ushtrimin e kontrollit të saj kushtetues do të hynte në vërtetësinë apo pavërtetësinë e fakteve të pranuar në vendimet gjyqësore. Sipas pikpamjes time, përgjigjja do të ishte negative. Në rastin në fjalë, nuk jemi para një vendimi që kualifikon drejt apo në mënyrë të gabuar nëse një ose disa veprime përbëjnë proces të parregullt gjyqësor. Një vendim i tillë, pa asnjë diskutim, do të ishte objekt i kontrollit të Gjykatës Kushtetuese. Në rastin konkret, fjala është për një vendim gjyqësor ku pranohen si të vërtetuara disa fakte, të cilat shumica, me vendimin e saj, i hedh poshtë si të pavërteta, duke dalë në këtë mënyrë jashtë funksionit dhe natyrës së organit. Gjykata Kushtetuese, në raport me vendimet gjyqësore, ka në kompetencë shqyrtimin e tyre, vetëm lidhur me respektimin e principeve themelore të procesit gjyqësor e jo dhe bazueshmërinë në ligj dhe në prova të themelit të çështjes apo të vërtetimit ose jo të fakteve që i shërbejnë proceduralisht zgjidhjes së çështjes.

ANËTAR  
A. Karamuço

### MENDIMI I PAKICËS

Pretendimet e kërkuesit për antikushtetueshmërinë e vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si rrjedhojë e mosmarrjes dijeni për ditën e gjykimit të çështjes, nuk duhet të pranoheshin nga shumica.

Që të arrihet në konkluzionin se të dy gjykatat kanë kryer një proces të parregullt ligjor, duke shkelur të drejtën e mbrojtjes së të gjykuarit, është e nevojshme për të bërë një analizë të gjithanshme të pretendimeve të kërkuesit. Nuk është i mjaftueshëm vetëm konstatimi nga Gjykata Kushtetuese i faktit të moskryerjes, në përputhje me dispozitat procedurale të njoftimit të të pandehurit për ditën e gjykimit, pa i vlerësuar këto pretendime edhe me arsyetimet që kanë përdorur të dy gjykatat në vendimet e tyre. Për një gjykim të karakterit kushtetues, duhet analizuar se sa ka ndikuar kjo shkelje e rregullave procedurale në të gjithë procesin gjyqësor dhe dhënia e argumentave kushtetuese për të shpallur si të tilla vendimet e gjykatave.

Rezultoni nga shqyrtimi i dosjes se të dyja gjykatat nuk e kanë lënë pa e analizuar momentin e njoftimit të të gjykuarit. Në procesverbalin e gjykatës së apelit, është pasqyruar fakti se i pandehuri Qerim Fekollari ka marrë dijeni për datën e gjykimit, por ai nuk është paraqitur. Në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është shkruar më tej, duke e argumentuar si të

pabazuar pretendimin e të gjykuarit për mosmarrje dijëni në gjykatën e apelit, pasi këtij Kolegji i rezulton nga dosja se i gjykuari paska marrë dijëni “për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë, por pa paraqitur ndonjë shkak ligjor nuk është paraqitur”. Pra të dy gjykatat i kanë dhënë përgjigje, duke e analizuar pretendimin e të gjykuarit për mohimin e të drejtës së mbrojtjes.

Në këto rrethana vlerësimin e faktit të marrjes dijëni ose jo e kanë vlerësuar gjykatat që kanë gjykuar çështjen dhe më duket se shumica nuk arsyeton drejt kur konkludon se njoftimi i të gjykuarit nuk është kryer konform ligjit. Përderisa gjykata e apelit, si dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë kanë arritur në përfundimin se i gjykuari nëpërmjet avokatit të tij ka marrë dijëni për ditën e gjykimit, atëherë si mundet që shumica të arsyetojë të kundërtën, duke konkluduar se procesi gjyqësor ka qenë i parregullt, sepse i gjykuari nuk është vënë në dijëni për ditën e gjykimit. Ky konkluzion i Gjykatës Kushtetuese, më duket se del tej juridiksionit që ajo ka, pasi vlerësimin dhe analizimin e provave apo fakteve e bëjnë gjykatat që shqyrtojnë çështjen.

Ndryshe do të arsyetoja nëse të dy gjykatat do të kishin heshtur ndaj pretendimit për mohimin e së drejtës së mbrojtjes që lidhet me njoftimin e të gjykuarit. Sigurisht që, ndaj vendimeve të tilla Gjykata Kushtetuese, mund të konkludonte për cenim të procesit ligjor, pasi është detyrë e gjykatave të zakonshme që të arsyetojnë për pretendimet lidhur me mohimin e të drejtave kushtetuese. Përderisa në çështjen objekt shqyrtimi kemi një qëndrim dhe vlerësim ndaj faktit të njoftimit, të arsyetuar në vendimet gjyqësore, atëherë shumica nuk mund të ketë të drejtë të konstatojë pavërtetësinë e këtij fakti.

ANËTAR  
Sokol Sadushi

**V E N D I M**  
**Nr.23, datë 23.4.2001**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                  |                                |    |
|------------------|--------------------------------|----|
| Fehmi Abdiu,     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |    |
| Sabri Rrapi,     | Anëtar i                       | ““ |
| Zija Vuci,       | Anëtar i                       | ““ |
| Hajredin Fuga,   | Anëtar i                       | ““ |
| Alfred Karamuço, | Anëtar i                       | ““ |
| Kristofor Peçi,  | Anëtar i                       | ““ |
| Kujtim Puto,     | Anëtar i                       | ““ |
| Sokol Sadushi,   | Anëtar i                       | ““ |

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 13.03.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.17 akti që i përket:

Kërkues: Çaus Minga, i përfaqësuar nga avokatët Myftar Hoxha e Bashkim Sulstarova, me prokurë.

**OBJEKTI:**

“Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.59, datë 15.7.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, nr.153, datë 21.12.1998, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.96, datë 24.2.2000, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë”.

Për shfuqizimin si antikushtetues të këtyre vendimeve, kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

- Gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar pa i njoftuar datën dhe orën e gjykimit, sipas neneve 333 e 350, paragrafi i katërt i Kodit të Procedurës Penale. Fletë-thirrja, drejtuar kërkuesit

nuk i është dorëzuar konform neneve 140 e 141 të Kodit të Procedurës Penale. Në këto rrethana, gjykata nuk duhej të deklaronte mungesën, por të shtynte seancën, duke përsëritur njoftimet.

-Gjykata e apelit, në kundërshtim me nenin 427, paragrafi i katët i Kodit të Procedurës Penale, me gjithë insistimin e avokatit, nuk pranoi kërkesën për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, megjithëse nga dosja dilte qartë se kërkuesi nuk kishte dijeni për gjykimin në shkallë të parë.

-Shkeljet e lejuara në të dy shkallët e gjykimit, përbëjnë një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të neneve 42 dhe 131, shkronja "f" të Kushtetutës dhe për rrjedhojë, i është cenuar rëndë e rejtja e mbrojtjes sipas nenit 31 të Kushtetutës. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndonëse janë bërë prezent këto shkelje, nuk i ka marrë në konsideratë.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin Hajredin Fuga, përfaqësuesit e kërkuesit që u shprehën për pranimin e kërkesës, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

Me vendimin nr.59, datë 15.7.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, kërkuesi është deklaruar fajtor dhe dënuar me 25 vjet burgim për veprat penale të vrasjes së një shtetasi, për tentativë varje të katër personave të tjerë dhe për armëmbajtje pa leje. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Nga përmbajtja e vendimeve, rezulton se ngjarja ka ndodhur më datën 25.8.1997 dhe kërkuesi është identifikuar menjëherë si autor i kësaj ngjarjeje, duke u larguar nga vendbanimi i tij, fshati Novaj i rrethit të Skraparit. Për këtë shkak, prokuroria e rrethit me shkresën e datës 20.2.1998, drejtuar Drejtorisë së Policisë Berat, ka urdhëruar shpalljen e kërkimit, gjetjen dhe ndalimin e kërkuesit për llogari të prokurorisë. Organi i policisë njofton prokurorinë se, nga verifikimi i bërë në vend, në banesën e kërkuesit, rezulton se ky ndodhet jashtë Shqipërisë. Duke u mbështetur në këtë njoftim, prokurori, në bazë të nenit 141, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale, ka deklaruar mosgjetjen dhe i ka caktuar kërkuesit mbrojtës kryesisht, të cilit i ka komunikuar vendimin për njoftimin e akuzës, e ka njohur me gjithë materialet e çështjes, si dhe me vendimin për dërgimin në gjyq të saj. Të gjitha këto akte të prokurorit janë nënshkruar nga avokati.

Në seancën e parë të gjykimit të datës 12.5.1998, nuk është paraqitur prokurori, kërkuesi dhe mbrojtësi i tij për shkak se nuk i ishin bërë njoftimet për datën e gjykimit. Për këtë shkak, gjykimi është shtyrë për në datën 26.5.1998 që të bëhen njoftimet përkatëse për secilin. Në seancën e datës 26.5.1998, është paraqitur prokurori dhe avokati, ndërsa kërkuesi nuk është paraqitur ndonëse në dosje ndodhet fletë-thirrja e gjykatës dërguar nëpërmjet zyrës postare, në emër të kërkuesit dhe në adresën e tij në fshat. Në fund, fletë-thirrja ka shënimin "languar në Greqi", pa u përcaktuar se nga kush është bërë ky shënim. Në këto rrethana, gjykata pasi ka dëgjuar palët, ka deklaruar mungesën, në vështrim të nenit 351 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe përfaqësimin e të pandehurit nga mbrojtësi, duke vazhduar gjykimin në mungesë. Meqenëse gjykimi u shty për në datën 5.6.1998, prokurori ka nxjerrë urdhrin e datës 27.5.1998, me anë të të cilit urdhërohet kërkuesi nëpërmjet organit të policisë, që të paraqiet në gjykatë më datën 5.6.1998, por përsëri policia njofton se nga verifikimet e bëra, ai ndodhet jashtë shtetit.

Veprimet e kryera, si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë gjykimit, kanë synuar që të plotësojnë detyrimin ligjor për njoftimin dhe pjesëmarrjen e të pandehurit në hetim dhe gjykim, por mosparaqitja e tij ka ardhur për shkak të fshehjes nga drejtësia. Këtë e përforcon edhe fakti se i pandehuri, duke qenë në kërkim, është kapur në një banesë në fshatin Portëz të rrethit të Fierit më datën 4.9.1998, pra rreth 13 muaj pas ngjarjes dhe afro 2 muaj pasi kishte përfunduar gjykimi në shkallë të parë. Në këto rrethana, organi procedues, duke i caktuar mbrojtës kryesisht, i cili e ka përfaqësuar të pandehurin, si gjatë hetimeve paraprake, ashtu edhe në gjykimin e çështjes, ka vepruar konform rregullave procedurale për respektimin e së drejtës së mbrojtjes, prandaj nuk qëndron pretendimi i parashtruar në kërkesë për shkeljen e së drejtës kushtetuese të mbrojtjes. Gjithashtu, nuk qëndron pretendimi për shkeljen e së drejtës për t'u dëgjuar, pasi, sipas nenit 33,

paragrafi i dytë i Kushtetutës, nga e drejta për t'u dëgjuar nuk përfiton personi që i fshihet drejtësisë.

Në gjykimin në shkallë të dytë, sipas prokurave që ndodhen në dosje, kërkuesi ka autorizuar avokatin Shuaip Syri dhe më pas, avokatin Njazi Hamzaraj që ta përfaqësojnë, qoftë edhe në mungesë para kësaj gjykate. Gjykimi në Gjykatën e Apelit Vlorë është zhvilluar me pjesëmarrjen e avokatit të zgjedhur nga vetë kërkuesi. Nga kjo gjykatë, nuk është pranuar kërkesa për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, sipas nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale, sepse nuk ka konstatuar raste të tilla që e bëjnë të detyrueshme rishqyrtimin e çështjes, për arsye se mospjesëmarrja e kërkuesit në gjykimin e shkallës së parë, nuk është për shkaqe ligjore. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, të cilit i janë parashtruar të njëjtat pretendime për gjykimin në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë, i ka vënë në diskutim shkeljet që përmenden në rekurs dhe, duke i arsyetuar një për një, ka konkluduar se këto shkelje nuk qëndrojnë. Sipas Kolegjit Penal, kërkuesi i është fshehur hetimit dhe gjykimin, prandaj dhe nuk është paraqitur në gjykimin në shkallë të parë, ndërsa gjykata e apelit, nuk ka pranuar të përsërisë rishqyrtimin e çështjes pasi sipas nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale, kjo është në diskrecion të gjykatës të vlerësojë nëse duhet përsëritur ose jo tërësisht apo pjesërisht gjykimi, kur i pandehuri nuk paraqitet në gjykim për shkaqe jo ligjore..

Gjykata Kushtetuese, duke i analizuar të gjitha pretendimet e parashtruara në kërkesë, arrin në përfundimin se shkaqet për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore si antikushtetues, nuk qëndrojnë dhe, për rrjedhojë, kërkesa e kërkuesit duhet rrëzuar.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 gërma "f" të Kushtetutës dhe nenit 72 të Ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" njëzëri,

#### V E N D O S I:

-Rrëzimin e kërkesës  
-Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

#### V E N D I M

**Nr.24, datë 24.4.2001**

#### **“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                  |                                |    |
|------------------|--------------------------------|----|
| Fehmi Abdiu,     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |    |
| Sabri Rrapë,     | Anëtar i                       | ““ |
| Zija Vuci,       | Anëtar i                       | ““ |
| Hajredin Fuga,   | Anëtar i                       | ““ |
| Alfred Karamuço, | Anëtar i                       | ““ |
| Kristofor Peçi,  | Anëtar i                       | ““ |
| Kujtim Puto,     | Anëtar i                       | ““ |
| Sokol Sadushi,   | Anëtar i                       | ““ |

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 13.03.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.17 akti që i përket:

K Ë R K U E S: BESIM GECA dhe BESNIK GECA, përfaqësuar nga avokat Haki Kraja, me prokurë.

## O B J E K T I:

“Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.322, datë 06.10.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë”.

Kërkuesit, nëpërmjet avokatit të tyre, pretendojnë se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit është antikushtetues dhe kërkojnë shfuqizimin e tij, duke parashtruar shkaqet e mëposhtme:

- Ndonëse në rekurs janë ngritur shkaqe që parashikohen në nenin 432, shkronjat “a”, “b”, dhe “c” të Kodit të Procedurës Penale, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nuk ka pranuar ta kalojë çështjen në seancë, duke i mohuar kërkuesve të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur;

- Vendimi i Kolegjit Penal, jo vetëm nuk është arsyetuar, por është shprehur edhe për zgjidhjen e çështjes në themel, duke pranuar se gjykatat në marrjen e vendimit kanë zbatuar drejt ligjin penal dhe normat e tjera juridike, konkluzione të cilat janë atribut i një procesi të rregullt ligjor me pjesëmarrjen e palëve dhe jo i Dhomës së Këshillimit.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin Sokol Sadushi, shpjegimet e përfaqësuesit të kërkuesve dhe analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

Avokati i të pandehurve Besim e Besnik Geca, me cilësinë e përfaqësuesit të tyre, ka ushtruar rekurs pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndaj vendimeve të Gjykatës së Rrethit Kukës dhe Gjykatës së Apelit Shkodër. Rekursi, i ushtruar në emër të kërkuesve, përmban tre shkaqe që lidhen me cilësimin e gabuar ligjor të veprës penale, me shkelje të normave procedurale gjatë gjyqimit, të cilat kanë ndikuar në mohimin e së drejtës së mbrojtjes së tyre, si dhe me karakterin haptazi jo logjik të arsytimit të vendimeve gjyqësore. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, pasi ka arsyetuar se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mospranimin e rekursit, si të pabazuar në ligj.

Gjykata Kushtetuese, duke e shqyrtuar këtë çështje në aspektin e pretendimeve të kërkuesve, për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese nga një proces i parregullt ligjor, konkludon se kërkesa e tyre për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të sipërcituar duhet pranuar.

Shkaqet që kanë parashtruar kërkuesit në rekursin e tyre drejtuar Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nga pikëpamja formale, përputhen me kërkesat ligjore që parashikon neni 432 shkronjat “a”, “b”, dhe “c” të Kodit të Procedurës Penale. Në vendimin e Kolegjit Penal, megjithëse pranohet se kërkuesit kanë pretenduar si shkak për prishjen e vendimeve, cilësimin e gabuar ligjor të veprës penale nga gjykatat, në dispozitiv, është vendosur mospranimi i rekursit. Nga mënyra se si Kolegji Penal e ka shqyrtuar çështjen në Dhomën e Këshillimit dhe vendimi që ai ka marrë, Gjykata Kushtetuese konkludon se mpleksja e kompetencave të Kolegjit në Dhomën e Këshillimit me atributet që ai ushtron gjatë seancës gjyqësore, që në rastin konkret janë evidente, kanë cenuar procesin ligjor.

Shqyrtimi i rekursit në Dhomën e Këshillimit është krejt i ndryshëm nga shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore. Detyrë e Dhomës së Këshillimit është të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë të tilla që të përputhen me kërkesat e nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale. Mjafton ekzistenca e këtyre shkaqeve ligjore, por pa i hyrë vlerësimi të tyre në fakt, që çështja të kalohet në seancë gjyqësore. Duke qenë se Dhoma e Këshillimit nuk është e pajisur nga ligji me atributet e shqyrtimit të çështjes në themel dhe as të zgjidhjes së drejtësisë së vendimit, sigurisht, mbetet seanca gjyqësore që të vlerësojë bazueshmërinë në ligj të shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs dhe të vendimit gjyqësor. Pikërisht, është neni 441 i Kodit të Procedurës Penale që parashikon formulimin që duhet të ketë dispozitivi i vendimit, sipas të cilit ndryshimi ose jo i cilësimit ligjor të veprës penale, që është dhe një ndër shkaqet kryesore të ngritura në rekurs, mbetet e drejtë e Kolegjit Penal në seancë gjyqësore.

Gjithashtu, arsyetimi i përdorur në vendimin objekt shqyrtimi, se “gjykatat në marrjen e vendimit kanë zbatuar drejt ligjin penal dhe normat e tjera juridike”, përbën një konkluzion përfundimtar të shqyrtimit të çështjes në themel, në të cilin ka arritur Kolegji Penal në Dhomën e Këshillimit, por që nuk mund të përputhet me kuptimin ligjor që ligjvënësi ka formuluar për mospranimin e rekursit.

Nga argumentat e parashtruara më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se moskalimi i çështjes në seancë gjyqësore nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndërkohë që shqyrtimi dhe dhënia zgjidhje shkaqeve ligjore të parashtruara në rekurs nuk i përket Dhomës së Këshillimit, i ka mohuar kërkesve të drejtën për t’u mbrojtur dhe dëgjuar nëpërmjet avokatit të tyre, duke mos u garantuar njëkohësisht zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 dhe 132 të Kushtetutës si dhe neneve 72 e 77, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.322, datë 06.10.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

#### V E N D I M

**Nr.25, datë 24.4.2001**

#### “NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                  |                                |    |
|------------------|--------------------------------|----|
| Fehmi Abdiu,     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |    |
| Zija Vuci,       | Anëtar i                       | ““ |
| Hajredin Fuga,   | Anëtar i                       | ““ |
| Alfred Karamuço, | Anëtar i                       | ““ |
| Kristofor Peçi,  | Anëtar i                       | ““ |
| Kujtim Puto,     | Anëtar i                       | ““ |
| Sokol Sadushi,   | Anëtar i                       | ““ |
| Sabri Rrapi,     | Anëtar i                       | ““ |

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 21.03.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.24 akti që i përket:

K Ë R K U E S:ARTIN BOJNI, i përfaqësuar nga avokati Ali Metaj.

#### O B J E K T I:

“Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.328, datë 06.10.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. (Nenet 33/1, 42/1 dhe 131/f të Kushtetutës)”.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë:

Kolegji Penal, padrejtësisht, nuk ka kaluar çështjen për shqyrtim në seancë të rregullt



gjqësore, pasi rekursi përmban shkaqe të parashikuara nga neni 432 pika 1 gërma “a” e Kodit të Procedurës Penale, “për zbatim të gabuar të ligjit”.

Kolegji Penal, në kundërshtim me nenin 42 pika 1 të Kushtetutës, i ka mohuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në një proces të rregullt ligjor.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin Sabri Rrapi, shpjegimet e përfaqësuesit të kërkuarit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

#### V Ë R E N:

Kërkuari Artin Bojni, me vendimin nr.116, datë 28.02.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është deklaruar fajtor për vjedhje me dhunë, të mbetur në tentativë, sipas nenit 139 dhe 22 të Kodit Penal. Ky vendim, është lënë në fuqi me vendimin nr.200, datë 11.05.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, rekursin e paraqitur nga kërkuari e ka shqyrtuar në Dhomën e Këshillimit dhe, në bazë të nenit 433 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se “rekursi i paraqitur nga i pandehuri nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale dhe se nga ana e gjykatës, në marrjen e vendimit është zbatuar drejt ligji penal dhe normat e tjera juridike”. Kërkuari Artin Bojni, në rekursin kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit ka parashtruar se cilësimi i veprës penale, nga vjedhje me pasojë vdekje, në vjedhje me dhunë të mbetur në tentativë, është i gabuar, pasi sipas tij, jemi përpara veprës penale të moskallzimit të krimit, të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

Nga përmbajtja e rekursit të paraqitur Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, del se kërkuari ka ngritur pretendimin se është zbatuar gabim ligji ndaj tij, shkak ky që parashikohet në nenin 432 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Penale. Por, edhe në vendimin e Kolegjit Penal, ndonëse pranohet se kërkuari ka pretenduar si shkak për prishjen e vendimeve, cilësimin e gabuar të veprës penale nga gjykatat, në dispozitiv të tij është vendosur në Dhomën e Këshillimit, mospranimi i rekursit.

Në këto rrethana, çështja duhet të kalonte për gjykim në seancë të rregullt gjyqësore. Duke mos pranuar rekursin në Dhomën e Këshillimit, Kolegji Penal i ka mohuar kërkuarit të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në një proces të rregullt ligjor. Këto shkelje të Kolegjit Penal, janë antikushtetuese, pasi vijnë në kundërshtim me nenin 42, pika 1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

Vendimi i Kolegjit Penal, i dhënë në Dhomën e Këshillimit, është antikushtetues edhe për faktin se ky Kolegj i ka hyrë vlerësimit të vendimit të Gjykatës së Apelit, ku thuhet se “Nga ana e gjykatës në marrjen e vendimit, është zbatuar drejt ligji penal dhe normat e tjera juridike”. Ky konkluzion i shprehur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, është atribut i një procesi të rregullt ligjor, me pjesëmarrjen e palëve dhe jo i Dhomës së Këshillimit. Pra, Dhoma e Këshillimit nuk mund të shqyrtojë çështjen në themel dhe as të zgjidhë drejtësinë ose jo të vendimeve të gjykatave më të ulëta, pasi një të drejtë të tillë e ka Kolegji Penal në seancë gjyqësore.

Duke u ndodhur çështja si më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimi i Kolegjit Penal, marrë në Dhomën e Këshillimit, duhet të shfuqizohet si antikushtetues dhe çështja të dërgohet për gjykim në kolegjin penal të Gjykatës së Lartë.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131/f të Kushtetutës dhe në neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

## V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.328, datë 06.10.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Dërgimin e çështjes për gjykim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

## MENDIMI I PAKICES

Kërkesa duhej të rrëzohej për këto arsye:

Kërkuesi ka pretenduar (dhe shumica ka pranuar) se në shqyrtimin e rekursit të paraqitur nga ai, Kolegji Penal në Dhomën e Këshillimit ka zhvilluar një proces jo të rregullt në kuptimin kushtetues. Sipas kërkuesit dhe vendimit të shumicës, rekursi i paraqitur nga ai duhej të kalonte për shqyrtim gjyqësor sepse në atë janë ngritur pretendime që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit (cilësimin ligjor të veprës penale).

Parë nga pikëpamja formale, pakica nuk ka kundërshtim se pretendimet për cilësim të gabuar të veprës penale, në përgjithësi përbëjnë shkak për të ushtruar rekurs në kuptim të nenit 432 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale. Por, nga shqyrtimi i dosjes penale del plotësisht e qartë se gjykatat kanë ndryshuar cilësimin juridik të veprës, duke u nisur nga vlerësimi i provave të administruara, fakt me mjaft rëndësi, por që nuk pasqyrohet në vendimet e shumicës.

Pakica ka mendimin e palëkundur se kur cilësimi juridik i veprës kontestohet, duke iu referuar vlerësimit të provave, ndryshe nga ai që kanë bërë gjykata e faktit dhe e apelit, rekursi nuk mund të kalojë për shqyrtim. Të pranosh të kundërtën, ashtu siç ka ndodhur me vendimin e shumicës në çështjen konkrete, do të thotë të vësh Gjykatën e Lartë në një pozicion të kundërligjshëm (të cilin vetë Gjykata Kushtetuese në një sërë vendimesh e ka goditur), atë të rivlerësimit të provave të administruara e të vlerësuara në të dy shkallët e gjyqimit.

A N Ë T A R  
A. Karamuço

## V E N D I M Nr.26, datë 24.4.2001

### “NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                  |                                |
|------------------|--------------------------------|
| Fehmi Abdiu,     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Sabri Rrapë,     | Anëtar i ““                    |
| Hajredin Fuga,   | Anëtar i ““                    |
| Alfred Karamuço, | Anëtar i ““                    |
| Kristofor Peçi,  | Anëtar i ““                    |
| Kujtim Puto,     | Anëtar i ““                    |
| Sokol Sadushi,   | Anëtar i ““                    |
| Zija Vuçi,       | Anëtar i ““                    |

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 19.12.2000 dhe 15.01.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.94/3 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: AVOKATI I POPULLIT, zoti Ermir Dobjani.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. AUREL SELMANI, i përfaqësuar nga avokati Krenar Loloçi.

## 2. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

### O B J E K T I:

“Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të pikës 1 shkrojna “c”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.19, datë 18.03.2000”.

Kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e kësaj dispozite, duke parashtruar këto shkaqe:

1. Ajo vjen në kundërshtim me pikën 1 të nenit 4 të Kushtetutës, që garanton të drejtën e pronës private. Duke i dhënë shtetit, me rastin e privatizimit të shoqërive tregtare me kapital shtetëror të drejtën e disponimit edhe për truallin që u është kthyer ish- pronarëve me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo dispozitë cenon padrejtësisht të drejtën e tyre si pronarë ekskluzivë të kësaj prone. Mbi këtë pronë që nuk është e tija, shteti nuk ka të drejtë të bëjë asnjë disponim.

2. Përsa i përket kategorisë tjetër të ish-pronarëve që Komisionet e Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave vetëm i kanë njohur atyre të drejtën e pronësisë mbi këto troje, këta përsëri e kanë fituar këtë pronë, por meqënëse kjo i nënshtrohet kufizimeve të vendosura nga shteti, ky është i detyruar, në bazë të pikës 4 të nenit 41 të Kushtetutës, t’i japë atyre një shpërblim të drejtë.

3. Kriteri i pranuar në këtë dispozitë për përllogaritjen e këtij shpërblimi, që jepet në formë aksionesh, duke ju referuar çmimit të shitjes së trojeve shtetërore të përcaktuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.06.1994, ka krijuar një pabarazi të dukshme në trajtim, midis kësaj kategorie pronarësh dhe atyre që iu shpronësohet prona për interes publik, sepse shpërblimi për këta të fundit shkon deri në 5 herë më shumë.

### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin Zija Vuci, Avokatin e Popullit, avokatin e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

Pika 1 shkronja “c” e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.199, datë 18.03.2000, e denoncuar nga Avokati i Popullit për papajtueshmëri me Kushtetutën, ka këtë përmbajtje: “Ish-pronarët e truallit kanë të drejtë të marrin aksione të shoqërisë që privatizohet në bazë të sipërfaqes së truallit brenda kufizimit të shoqërisë dhe çmimit të truallit të përcaktuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.06.1994”.

Në seancë plenare, kërkuesi ka sqaruar përmbajtjen e kërkesës, duke parashtruar se atë e ka ushtruar në interes të të gjithë ish-pronarëve, pa përjashtuar edhe ata që Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave iu ka njohur vetëm të drejtën e kompensimit të truallit.

Gjykata Kushtetuese, pasi analizoi shkaqet për të cilat është kërkuar shfuqizimi i dispozitës së lartpërmendur, konkludon se disa prej këtyre shkaqeve meritojnë të merren në konsideratë pasi ka argumenta, të cilat hedhin dritë mbi karakterin antikushtetues të një pjese të kësaj norme juridike.

Dihet se qëllimi i daljes së saj ka qenë përgatitja e terrenit për të vënë në jetë një formë të re kompensimi, të krijuar me ligjin nr.8334, datë 23.04.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, por pa ju shmangur frymës që përshkon Kushtetutën dhe ligjin nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”. Referimi i kësaj dispozite në çmimet e shitjes së trojeve shtetërore, të përcaktuara sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.06.1994 dhe vlerësimi në bazë të këtyre çmimeve i sipërfaqes së truallit ish-pronë private e ndodhur kjo brenda kufizimit të shoqërisë tregtare, e redukton në mënyrë të ndjeshme të drejtën për kompensim të ish-pronarit. Vlera e këtij trualli, që i jepet atij në formë aksionesh është disa herë më e vogël se ajo që është vendosur t’i kompensohet nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Kjo për arsye se çmimet shtetërore për këtë kategori sendesh të palujtshme, aktualisht janë më të ulta se çmimet që diktohen nga nevojat e tregut. Për më tepër, në këtë dispozitë nuk parashikohet, me nënkuptimin që nuk lejohet as konvertimi i kësaj vlere, sipas

indeksit të rritjes së çmimeve. Është e qartë, se një rregullim i tillë dëmton interesat e kësaj kategorie ish-pronarësh. Ai iu kufizon atyre të drejtën për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga veprimet e paligjshme të organeve shtetërore. Kjo është një e drejtë themelore që ka gjetur pasqyrim në nenin 44 të Kushtetutës dhe rrugët për realizimin e saj janë caktuar veçanërisht në ligjin 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Format e kompensimit të parashikuara në këtë ligj, si edhe ajo e krijuar rishtaz me ligjin nr.8334, datë 23.04.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, vërtet ndryshojnë nga njëra-tjetra, por të gjitha udhëhiqen nga i njëjti qëllim: që të ndreqin, brenda mundësive dhe kushteve ekonomiko-sociale të vendit padrejtësitë e regjimit të kaluar, të kryera në dëm të pronës private, nëpërmjet shtetëzimeve, shpronësimeve, konfiskimeve ose me çdo mënyrë tjetër të padrejtë.

Për arritjen e këtij qëllimi, kërkohet që detyrimeve të shtetit për kompensimin e trojeve të zëna, për aq sa kanë vendosur komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave, t’iu korrespondojë e drejta e ish-pronarëve të truallit, e cila, duke u vlerësuar ekonomikisht, të mos jetë nën nivelin e kërkesës kushtetuese për një shpërblim të drejtë.

Veç kësaj, mosrespektimi i këtij kriteri në formulimin e dispozitës së sipërpërmendur të Këshillit të Ministrave, i lë shteg edhe një shkelje tjetër kushtetuese.

Ish-pronarët, të cilëve ajo iu adresohet, vihen në kushte pabarazie në krahasim me ish-pronarët e tjerë të trojeve të zëna me objekte të ndërtuara nga shteti, ku nuk zhvillojnë aktivitet shoqëritë tregtare të komanduara prej tij.

Të dy këto grupe ish-bashkëpronarësh ndodhen në situata juridike të njëllota dhe i përkasin të njëjtës kategori. Si njërit, ashtu dhe tjetrit, nuk i është kthyer trualli për shkak se ka qenë i zënë dhe komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave, iu kanë njohur atyre vetëm të drejtën e kompensimit.

Në aspektin ekonomik, kjo e drejtë, në çdo formë që të realizohet, duhet t’iu sigurojë titullarëve të saj përfitime pasurore tek të cilat të mos vërehen ndryshime të dukshme. Një kërkesë e tillë është e lidhur me nevojën e zbatimit të parimit kushtetues të barazisë përpara ligjit, të sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës. Në fakt, dispozita e kontestuar nga Avokati i Popullit, duke iu referuar çmimeve të përcaktuara sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.06.1994, për vlerësimin e aksioneve të destinuara për ish-pronarët e këtyre trojeve, i kundërvihet këtij parimi.

Fakti se këto troje ndodhen brenda kufizimit të shoqërisë tregtare të komanduar nga shteti, nuk do të thotë që ish-pronarët e tyre të trajtohen ndryshe nga ish-pronarët e tjerë që nuk u janë kthyer pronat. Prania e kësaj rrethane, në kuptim të nenit 18 pika 2 të Kushtetutës, nuk përbën shkak të arsyeshëm për të përligjur dallimin midis tyre.

Pra, i vetmi burim i këtyre shkeljeve kushtetuese është referenca e kësaj dispozite në çmimet e përcaktuara sipas vendimit të sipërm të Këshillit të Ministrave. Për rrjedhojë, ajo në këtë pjesë duhet të shfuqizohet, me qëllim që ky organ shtetëror të bëjë një formulim të ri të këtij akti normativ. Për këtë, është e nevojshme të respektohen mirë e me kujdes kërkesat e nenit 181 të Kushtetutës.

Kjo dispozitë i ve si detyrë shtetit që, brenda një afati të caktuar, 2-3 vjeçar, të bëjë rregullimet e nevojshme ligjore për çështjet që lidhen me shpronësimet e konfiskimet e kryera përpara miratimit të Kushtetutës. Në këtë kategori çështjesh bën pjesë edhe ajo që i përket pa përjashtim të gjithë ish-pronarëve që nuk ju është kthyer trualli.

Mënyra e kompensimit të tyre, sipas kësaj norme kushtetuese, do të bëhet duke u udhëhequr nga kriteret e përcaktuara në nenin 41 pika 4 të Kushtetutës, i cili parashikon se shpronësimet ose masat e tjera kufizuese të pronësisë, të vendosura për interesa publikë, lejohen vetëm përkundërt një shpërblimi të drejtë.

Zbatimi i këtij kriteri në zgjidhjen e problemit të këtyre ish-pronarëve, diktohet edhe nga fakti se e drejta e tyre për kompensim, ndonëse është një e drejtë kredie, prejardhjen dhe bazën e saj e ka në të drejtën reale të pronësisë mbi truallin, i cili nuk i përket më atyre, por aktualisht i përket shtetit.

I ndryshëm është qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese, përse i përket shkaqeve të tjera për të

cilat kërkohet të deklarohet e papajtueshme me Kushtetutën, dispozita që përbën objektin e kësaj kërkese.

Në kundërshtim me sa ka pretenduar kërkuesi, ajo nuk iu adresohet ish-pronarëve që komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave ju kanë kthyer trojet. Edhe në qoftë se këto prona ndodhen brenda kufizimit të shoqërive tregtare, ata e kanë rifituar të drejtën e pronësisë mbi këtë pasuri. Qënia e tyre si titullarë të vetëm të kësaj prone, nuk mund të vihet në dyshim, aq më tepër në qoftë se ata e kanë hedhur atë në emër të vet pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të palujtshme.

Por, pavarësisht nga kjo mangësi, kërkesa është e argumentuar dhe për arsyet që u thanë më sipër, duhet pranuar, duke u shfuqizuar pjesa referuese e pikës 1 shkronja “c” e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000.

Meqënëse ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 42/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” duhet të shfuqizohet si antikushtetuese edhe pjesa referuese e pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.438, datë 14.08.1995, e cila ka të njëjtën përmbajtje.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në nenin 131 shkronja “c” të Kushtetutës dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 1 shkronja “c” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive që veprojnë në sektorët jo strategjike”, si dhe të pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.438, datë 14.08.1995 “Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare”, vetëm për pjesët ku ato shprehen: E para, “dhe çmimit të truallit të përcaktuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.06.1994” dhe e dyta, “...në përpjestime që i përgjigjen çmimit të truallit të njohur në bazë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.06.1994”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hynë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

#### MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër vendimit të shumicës që shfuqizoi si të papajtueshme me Kushtetutën pikën 1, gërma “c”, të vendimit nr.119, datë 18.03.2000 të Këshillit të Ministrave, për këto arsye:

Avokati i Popullit, në kërkesën e paraqitur në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë, ka kërkuar që të shfuqizohet si antikushtetues vendimi i Këshillit të Ministrave, pika 1 gërma “c”, me arsyetimin se vjen në kundërshtim me pikat 1 e 4, të nenit 41 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë, e cila goditet nga Avokati i Popullit, është parashikuar se ish-pronarët e truallit kanë të drejtë të marrin aksione të shoqërisë që privatizohet, në bazë të sipërfaqes së truallit, të përcaktuar në vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të ish-pronarëve, brenda kufizimit të shoqërisë dhe çmimit të truallit të përcaktuar sipas vendimit nr.312, datë 30.06.1994 të Këshillit të Ministrave.

Sipas kërkuesit, referimi tek vendimi nr.312, për përcaktimin e vlerës së truallit ish-pronë private, përbën shkelje të nenit 41/1 dhe 4 të Kushtetutës, sepse kjo pasuri e palujtshme, duke iu kthyer ish-pronarit është bërë pronë e tij, se ka pushuar së qëni si pronë shtetërore dhe se shteti nuk mund t’i diktojë atij çmimin e shitjes të kësaj pasurie, ashtu siç vepron me objektet që ka në pronësi dhe që janë ngritur mbi këtë truall. Ky arsyetim i kërkuesit nuk është i drejtë, prandaj dhe nuk duhej të pranohet. Ish-pronari i truallit, në rastin konkret, nuk është pronar i atij trualli dhe se ky truall nuk ka pushuar “së qëni pronë e shtetit”. Me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të

Pronave, ai është njohur si ish-pronar i truallit, por nuk mund t'i kthehej pasi ishte i zënë me objekte të ndërtuara plotësisht nga shteti, çka pajtohet me nenin 4 të ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", për rrjedhojë është pronë shtetërore derisa do të privatizohet. Në këto raste, ish-pronarit i njihet e drejta e kompensimit në një nga format e parashikuara në nenin 16 të ligjit nr.7698 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", ose kur është rasti, i njihet e drejta e parablerjes. Kur ish-pronari nuk është kompensuar për truallin e zënë, sipas pikës 1, gërma "c", të vendimit nr.119 të Këshillit të Ministrave, ka të drejtë të marrë aksione për truallin, në shoqërinë tregtare që privatizohet. Sipas këtij vendimi, për vlerën e truallit si pjesë e kapitalit themelor të shoqërisë, ish-pronari nuk merr pjesë në ankandin e aksioneve. Ai zotëron një përqindje të caktuar të aksioneve, e cila mbetet e pandryshuar, në raport me pjesën tjetër të kapitalit të shoqërisë, pavarësisht nga rezultati i ankandit.

Sipas këtij vendimi, çmuj se pronari nuk është kufizuar në të drejtën e pronës, sepse ai po të dëshirojë përfiton aksione lidhur me sipërfaqen e truallit dhe çmimin e tij, ndryshe ai ka të drejtë të kërkojë të kompensohet në një nga format e parashikuara në nenin 16 të ligjit nr.7698 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

Pra, pika 1 gërma "c" e vendimit që u kërkua të shfuqizohet, realizon të drejtën e ish-pronarëve për t'u kompensuar për ish-pronën e tyre kur privatizohen shoqëritë tregtare shtetërore dhe nuk ka të bëjë me çka parashikohet në nenin 41 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, që kërkuesi pretendon se është shkelur. Neni 41 i Kushtetutës, siç dihet, rregullon marrëdhëniet ndërmjet pronarëve ekzistues dhe shtetit kur bëhen shpronësime ose kufizime të të drejtës së pronësisë vetëm për interesa publike. Por, në këto raste ish-pronari i truallit nuk është pronar i tij për arsyet e përmendura më lart dhe as që mund të bëhet fjalë se kemi të bëjmë me rastet e shpronësimit dhe konfiskimit, neni 181 i Kushtetutës, siç pretendon kërkuesi.

Duke u ndodhur çështja si më sipër, nuk mund të pranohet se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000, krijon pabarazi aplikimi të çmimeve të parashikuara në vendimin nr.312, datë 30.06.1994 të Këshillit të Ministrave, si i vetmi kriter për llogaritjen e vlerës të trojeve ish-pronë private për efekt të konvertimit të saj në aksione, për shkak se nuk ndodhemi përpara shpronësimeve, por para privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorë jostrategjikë, ku kapitali është tërësisht shtetëror dhe jo e ish-pronarëve. Pra, në këto raste shteti shet pronën e tij.

Në këto rrethana, mendoj se kërkesa duhej të rrëzohej si e pa mbështetur.

A N Ë T A R  
S. Rrapi

#### ARSYETIM PARALEL

Që t'i jepet përgjigje kërkesës së Avokatit të Popullit, lidhur me kushtetutshmërinë e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, mendoj që paraprakisht duhet krijuar një koncept i qartë për përcaktimin e pronësisë së truallit që shtrihet nën një objekt, pra për pronësinë e truallit të zënë.

Pyetja që shtroj është: Ky truall, në bazë të ligjit "Për kthimin e pronave" është pronë shtetërore apo pronë private? Përgjigjen e kësaj pyetjeje e gjej në argumentat që do të rradhis më poshtë.

Ligji u njez ish pronarëve të drejtën e pronësisë.

Neni 1 i ligjit "Për kthimin e pronave ish pronarëve" parashikon: "ky ligj u njez ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të drejtën e tyre të pronësisë për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara apo të konfiskuara..., si dhe përcakton mënyrat dhe masat për kthimin apo kompensimin e tyre."

Neni 4 parashikon: "U njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen ish-pronarëve trojet e pazëna dhe ndërtesat, ndërsa neni 16 parashikon: "kur trojet janë zënë me ndërtime të përhershme pronarët kompensohen...". Ligji kur jep definicionin e pronës kupton pasurinë e palujtshme në

formën e tokës, pra si truall i zënë dhe i pazënë. Kjo është e parashikuar në nenin 2 dhe 3 të ligjit të sipërcituar.

Posedimi, gëzimi dhe disponimi janë tagre të pronarit dhe në tërësinë e tyre përbëjnë të drejtën subjektive të pronësisë. Këto tagre pronari i realizon vetë në mënyrë të pavarur, por nuk përjashtohet mundësia t'i realizojë edhe me anë të personave të tjerë. Në rastin kur pronari nuk i realizon vetë drejtpërdrejt këto tagre, ato përsëri i mbeten atij dhe, të tretët veçse ndihmojnë pronarin në bazë të marrëdhënies që ata kanë vendosur. Pra, të tre tagret e pronarit, veç e veç ose të gjitha së bashku mund t'i kalojnë një personi tjetër që nuk është pronar. Kjo mund të ndodhë:

- në bazë të kontratës së lidhur me pronarin, (psh., kontrata e qirasë, e depozitës),
- në bazë të një akti administrativ ose në bazë të ligjit (veprimet e përmbaruesit ndaj sendeve të sekuestruara, apo kur shteti i kalon subjekteve të së drejtës publike, institucioneve shtetërore këto të drejta).

Në të gjitha rastet, pronari nuk e humbet të drejtën e pronësisë, pasi ai vazhdon të mbetet pronar, por vetëm kufizohet përkohësisht mundësia për t'i ushtruar vetë këto tagre. Neni 149 i Kodit Civil parashikon se "Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji". Kjo do të thotë se e drejta e pronësisë nuk është absolutisht e pakufizuar. Këtu del një tipar tjetër i përmbajtjes së të drejtës së pronësisë që është karakteri i kufizuar i tagreve të pronarit.

Kur kufizohen tagret e pronarit ndodhemi përpara posedimit të jopronarit, i cili dihet që ndahet në posedim të ligjshëm dhe të paligjshëm. Në rastet që sipërcitova ndodhemi përpara posedimit të ligjshëm të jopronarit, sepse jopronari i ka këto tagre në bazë të një kontrate, të një akti administrativ apo të ligjit. Pra ai është një posedues i përkohshëm, por nuk është pronar.

Ligji "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" përmban pikërisht këtë kuptim që unë shtellova. Prona me këtë ligj u kthehet ish-pronarëve, pra atyre u njihet nga ligji e drejta e pronësisë, e cila në disa raste paraqitet si një e drejtë e kufizuar, sepse truall i zënë mbahet në mënyrë të ligjshme nga jopronari, që në rastin konkret është shteti. Vetë shteti u ka njohur të drejtën e pronësisë këtyre ish-pronarëve edhe mbi truallin e zënë, por nuk ua kthen. Kjo do të thotë se shteti nuk është më pronar i këtij truall të zënë. Këtë e ilustron me shembuj nga praktika e privatizimeve.

Në rastin kur ndodhemi përpara një objekti, psh., magazinë apo repart, që do të privatizohet, shteti i njeh ish-pronarit të drejtën e parablerjes së objektit, meqenëse ka një vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave. Ish-pronari e blen këtë objekt. Meqenëse ai bleu objektin, shteti automatikisht i jep edhe truallin, pa kryer asnjë akt formal, kontratë shitjeje, apo dhurimi me ish-pronarin e truallit. Nëse truall i zënë nën objekt do të konsiderohej pronë shtetërore, atëherë shteti, duhej detyrimisht ta shiste truallin, pra të përpilonte një kontratë. Por shteti nuk e shet dot truallin, sepse edhe vetë e kupton se nuk është pronar i tij dhe se ish-pronari është pronar i vërtetë.

Edhe në rastin kur objektin nuk e blen ish-pronari, por një i tretë, përsëri shteti nuk ka të drejtë të shesë truallin, pa kryer kompensimin për ish-pronarin. Pra, vetëm kur ish-pronari të jetë kompensuar me një nga format e kompensimit, psh., me obligacione, apo me truall, i cili është truall shtetëror, atëherë shteti si rrjedhojë e këtij kompensimi mund të bëhet pronar i truallit të zënë nën objekt dhe atëherë mund edhe t'ia shesë një të treti. Për sa kohë ish-pronari nuk është kompensuar në një nga format, truall i zënë mbetet pronë e tij.

Është e vërtetë se, në praktikën e kthimit të pronave, apo të privatizimeve, janë krijuar keqkuptime të ligjit, por mendoj se nuk duhet të nisemi nga kjo praktikë e ngatërruar ligjore, por nga kuptimi që ka apo që duhet të ketë ligji.

Përderisa ligji "Për kthimin dhe kompensimin e pronave" u njeh të drejtën e pronësisë ish-pronarëve dhe koncepti im për truallin e zënë konsolidohet në mendimin se nuk kemi të bëjmë me truall shtetëror, por me truall privat, atëherë kjo i jep zgjidhje çështjes tjetër që lidhet me kushtetutshmërinë e referimit tek vendimi nr.312 i Këshillit të Ministrave.

Pra, referimi që bën vendimi nr.119 i Këshillit të Ministrave, lidhur me të drejtën e ish-pronarëve për të përfituar aksione, duke e llogaritur truallin me çmimin që përcakton vendimi nr.312, është antikushtetues.

Për një truall që shteti nuk është pronar nuk mund të vendosë çmime. Shteti mund të

vendosë vetëm për t'i dhënë zgjidhje procesit të privatizimit. Meqenëse trualli i zënë është llogaritur, apo duhet llogaritur në kapitalin e shoqërisë anonime që do të privatizohet, pa dijeninë e pronarit të vërtetë të saj, atëherë mendoj se kemi të bëjmë me ato lloj kufizimesh të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin. Pra, përderisa pronari nuk mund të gëzojë lirisht pronën e tij, ky është një kufizim, por nga ana tjetër, edhe shteti, meqenëse duhet të kryejë procedurën e privatizimit është i detyruar t'i jap zgjidhje problemit. E vetmja zgjidhje e drejtë për të përfunduar procedurën e privatizimit si dhe për të mos cenuar pronarin e truallit, mbetet njohja e këtij veprimi si një kufizim në të drejtën e pronës dhe detyrimi për t'i dhënë pronarit shpërblimin e drejtë.

Ky është koncepti kushtetues dhe i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kriteret që parashikon neni 41 i Kushtetutës që janë garantimi i pronës private e shpërblimi i drejtë, si dhe koncepti i Konventës për gëzimin e pronës në mënyrë të qetë janë orientimet bazë mbi të cilat duhet të zgjidhen të gjitha çështjet që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera përpara miratimit të Kushtetutës, konformë dhe nenit 181 të saj.

Nisur nga ky arsytim, unë jam kundër arsyetimit të shumicës, por bashkohem me të vetëm në pjesën e dispozitivit të vendimit që pranon kërkesën duke e shfuqizuar si antikushtetues referimin tek vendimi nr.312 i Këshillit të Ministrave.

**A N Ë T A R**  
**Sokol Sadushi**

**V E N D I M**  
**Nr.27.datë 27.4.2001**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                  |                                |    |
|------------------|--------------------------------|----|
| Fehmi Abdiu,     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |    |
| Sabri Rrapi,     | Anëtar i                       | ““ |
| Zija Vuci,       | Anëtar i                       | ““ |
| Kujtim Puto,     | Anëtar i                       | ““ |
| Kristofor Peçi,  | Anëtar i                       | ““ |
| Sokol Sadushi,   | Anëtar i                       | ““ |
| Alfred Karamuço, | Anëtar i                       | ““ |

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 29.01.2001 dhe 26.04.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.6 akti që i përket:

**K Ë R K U E S:** KRYEMINISTRI I REPUBLIKES SE SHQIPERISE, i përfaqësuar nga zoti Ismail Lleshi, Ministër i Mbrojtjes.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

1. **PRESIDENTI I REPUBLIKËS**, i përfaqësuar nga zoti Ruzhdi Gjatoja.
2. **KUVENDI I SHQIPËRISË**, në mungesë.

**O B J E K T I:**

"Interpretimi i pikës 1, të nenit 12 të Kushtetutës".

**GJYKATA KUSHTETUESE:**

pasi dëgjoji relatorin Alfred Karamuço dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, zoti Ilir Meta, me shkresën nr.5055 Protokollit,



datë 4.12.2000, ka kërkuar para Gjykatës Kushtetuese interpretimin e pikës 1 të nenit 12 të Kushtetutës, në të cilin parashikohet se “Forcat e Armatosura sigurojnë pavarësinë e vendit si dhe mbrojnë tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues”.

Para përfundimit të çështjes, Kryeministri ka paraqitur, në Gjykatën Kushtetuese, shkresën me nr.1759 Prot., datë 25.04.2001, me anë të të cilës kërkon “kthimin pa veprim” të kërkesës së bërë për interpretim, me arsyetim se problemi që është parashtruar në Gjykatën Kushtetuese do të bëhet objekt rishqyrtimi në Këshillin e Ministrave.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkuesi ka hequr dorë nga gjykimi i kërkesës, veprim ky që ka sjell pushimin e gjykimit.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 124 pika 1 e 134, pika 1 shkronja “b” të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### V E N D O S I:

- Pushimin e gjykimit.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

#### V E N D I M

**Nr.1, datë 15.2.2001**

#### “NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga

|                   |         |
|-------------------|---------|
| Thimjo Kondi      | Kryetar |
| Ylvi Myrtja       | Anëtar  |
| Bashkim Caka      | “       |
| Agron Lamaj       | “       |
| Natasha Sheshi    | “       |
| Artan Hoxha       | “       |
| Metush Saraçi     | “       |
| Valentina Kondili | “       |
| Vladimir Metani   | “       |
| Nikoleta Kita     | “       |
| Vladimir Bineri   | “       |
| Zamir Poda        | “       |
| Kristaq Ngjela    | “       |
| Tefta Zaka        | “       |
| Perikli Zaharia   | “       |

në seancën gjyqësore të datës 15.2.2001, mori në shqyrtim çështjen nr.1 që u përket:

Të pandehurve : Qazim Lika, Qamil Lika e Zamir Lika,  
në mungesë.

Akuzuar: Për vjedhje me armë në bashkëpunim, armëmbajtje pa leje, parashikuar nga nenet 140- 25 dhe 278/2 të Kodit Penal.

Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr.107 datë 23.3.2000, ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Qazim Lika për kryerjen e veprës penale të vjedhjes me armë, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 140 e 25 të Kodit Penal, e dënimit e tij me 17 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Qazim Lika, për veprën penale të armëmbajtjes pa leje,

parashikuar nga nenet 278/2 të Kodit Penal, e dënimin me 1 vit burgim.

Në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin përfundimisht të të pandehurit Qazim Lika, me 17 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Qamil Lika për kryerjen e veprës penale të vjedhjes me armë, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 140 e 25 të Kodit Penal, e dënimin e tij me 17 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Qamil Lika, për veprën penale të armëmbajtjes pa leje parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal, e dënimin me 1 vit burgim.

Në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin përfundimisht të të pandehurit Qamil Lika, me 17 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Zamir Lika, për kryerjen e veprës penale të vjedhjes me armë, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 140 e 25 të Kodit Penal, e dënimin e tij me 17 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Zamir Lika, për veprën penale të armëmbajtjes pa leje parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal e dënimin me 1 vit burgim.

Në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin përfundimisht të të pandehurit Zamir Lika, me 10 vjet burgim.

Në aplikim të nenit 51 të Kodit Penal, gjykata përfundimisht e dënon të pandehurin Zamir Lika me 5 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr.56, datë 2.5.2000 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.107 datë 23.3. 2000 të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

Kundër vendimit nr.56 datë 2.5.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër kanë ushtruar rekurs tre të pandehurit duke parashtruar këto shkaqe:

Janë keqtrajtuar nga policia.

Nuk ka prova për fajësinë.

I pandehuri Zamir Lika është ndodhur në kushtet e detyrimit e kërcënimit

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 245 akti, datë 5.10.2000, ka vendosur:

Kalimin e çështjes Kolegjeve të Bashkuara për të unifikuar praktikën gjyqësore, lidhur me pjesëmarrjen e të pandehurit të lirë ose të arrestuar, në gjykimin në gjykatën e apelit, me arsyetimin:

Gjykimi në apel në mungesë të të pandehurve.

Gjykata ka realizuar njoftimin e avokatëve dhe jo të të pandehurve duke mosrespektuar kërkesat e neneve 425/1 dhe 139/1 e 2 të Kodit Penal.

Në praktikë, megjithë qëndrimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përsëri vërehen shkelje rreth kësaj çështje.

Si duhen kuptuar nenet 331/1 i Kushtetutës dhe 128/c, 426/1 dhe 139 e vijues të Kodit Penal Penale.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë

pasi dëgjuan relacionin e anëtarëve Zamir Poda e Bashkim Caka:

pasi dëgjuan prokurorin Mihallaq Bleta, i cili kërkoi prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër,

## V Ë R E J N E:

Vendimi nr.56 datë 2.5.2000 i Gjykatës së Apelit Shkodër, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit. Për pasojë, ai duhet të prishet dhe çështja i duhet dërguar për rishqyrtim po asaj Gjykate.

Si gjykata e shkallës së parë ashtu edhe Gjykata e Apelit Shkodër kanë pranuar, se në datën 20.12.1999 rreth orës 11.00 të pandehurit Qazim Lika dhe Qamil Lika, vëllezër si dhe Zamir Lika, nip i tyre, me kapuçë në kokë dhe të armatosur respektivisht i pari me automatik, i dyti me pushkë e i treti me automatik, kanë ndaluar dhe vjedhur me armë pasagjerë të dy kamionëve. Kështu, ata kanë ndaluar nën kërcimin dhe krismat e armëve, së pari një kamion të tipit "IFA", në të cilën udhëtonin shoferi Gegë Ballza dhe pasagjerët Dedë Plepi, Gjolek Plepi, Gjergj Tonaj, Kolë Polia, Sandër Ashta, Nikollë Selvia, Gjon Nika dhe Ndue Koceku dhe u kanë marrë para e sende të tjera

me vlerë. Më pas, në interval kohor prej 20 minutash, ata kanë ndaluar sërish, duke kërcënuar me armë një kamion tjetër të tipit "IFA". Në momentin kur kanë kërkuar para, ata janë përballur me policë, të cilët udhëtonin në atë kamion. Menjëherë dy të pandehurit Qazim e Qamil janë larguar, ndërsa është kapur në vend, i pandehuri Zamir Lika. Më pas, organet e policisë kanë bërë të mundur edhe kapjen e dy të tjerëve.

Duke e parë vendimin e gjykatës së apelit në tërësinë e tij, arrihet në përfundim se ai është marrë në kundërshtim me kërkesat ligjore, mbasi nuk është siguruar e drejta ligjore e pjesëmarrjes dhe dëgjimit të të pandehurit në gjykim. Në gjykimet e gjykatave të apelit, megjithë qëndrimin konstant të mbajtur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë përsëri vërehet një dukuri e tillë e kundërligjshme.

Me të drejtë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se një moment i tillë nuk është parashtruar në rekursin e paraqitur nga të pandehurit, në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 434 të Kodit Procedural Penale, kryesisht ka konstatuar mosthirrjen e njoftimin e të pandehurve në gjykimin në apel.

Urdhërimin për thirrjen dhe njoftimi i të pandehurit, për të marrë pjesë në gjykimin në apel, është një detyrim ligjor dhe jo fakultet për gjykatën.

Një përfundim i tillë, kategorik, buron nga analiza që u bëhet dispozitive përkatëse që rregullojnë të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit në procesin penal, si dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të parashikuara në Kushtetutë, në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në Kodin e Procedurës Penale.

Në praktikën gjyqësore të gjykatave të apelit, pikërisht lidhur me thirrjen dhe njoftimin e të pandehurit në gjykim, efektivisht janë vërejtur janë qëndrime të ndryshme të kundërligjshme dhe konkretisht:

Mosurdhërimin e thirrjes dhe njoftimin e të pandehurit të lirë apo të arrestuar.

Njoftimin vetëm të mbrojtësit të të pandehurit.

Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga mbrojtësi, për urdhërimin e thirrjes dhe njoftimin e të pandehurit.

Urdhërimin e thirrjes së të pandehurit, por mosrespektimin e kërkesave ligjore për njoftimin e të pandehurit të burgosur.

Siç shihet , në të gjitha rastet, në substancë kemi të bëjmë me mosgarantim të sigurimit të të drejtës së mbrojtjes për të pandehurin.

Sipas kërkesave të nenit 31 të Kushtetutës, "Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: ...ç. të mbrohet vetë ose..."

Formulimi i bërë në dispozitë kushtetuese të mësipërme është i njëjtë me formulimin e nenit 6 pika 3 gërma "c" të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, sipas të cilit "...Çdo i akuzuar ka të drejtë, ndër të tjera dhe kryesisht:

c) Të mbrohet vetë ose..."

Më tej akoma, në nenin 33 pika 1 të Kushtetutës, parashikohet:

1.Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet.

Nga ana tjetër, ligjvënësi në nenin 426 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohen veprimet paraprake të gjykimin në Gjykatën e Apelit, ka përcaktuar se:

1. Kryetari i Kolegjit të Gjykatës së Apelit urdhëron thirrjen e të pandehurit...

Sigurimi të drejtës së pjesëmarrjes dhe dëgjimit të të pandehurit në gjykimin në apel, është një veprim i domodoshëm, jo vetëm në aspektin kushtetues e ligjor, por edhe për faktin se gjykata e apelit në dallim nga Gjykata e Lartë, gjykon edhe si gjykatë fati. Kështu duke iu referuar kërkesave të parashikuara në nenin 427 të Kodit të Procedurës Penale, kemi:

1.Kur një palë kërkon rimarrjen e provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja, gjykata në qoftë se e çmon se një gjë e tillë është e nevojshme, vendos përsëritjen tërësisht ose pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor.

2. Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor vendoset edhe kryesisht kur gjykata e çmon të domosdoshme.

3.Gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor kur vërtetohet se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në shkallë të parë..."

Ndërsa shqyrtimi në Gjykatën e Lartë, në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale, bëhet vetëm për shkaqe të përcaktuara që kanë të bëjnë me...” mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit penal ose normave të tjera juridike...mosrespektim të normave procedurale që parashikojnë si pasojë pavlefshmërinë, mospranimin ose humbjen e një të drejte të ligjshme...mungesën e arsytimit ose karakterin haptazi jo logjik...”

Duke i parë në unitet të gjitha dispozitat e cituara më sipër, arrihet në përfundimin se pjesëmarrja e të pandehurit të lirë apo të arrestuar në gjykim (edhe në apel), dëgjimi dhe mbrojtja e tij, ndërsa për të (pandehurin) është një e drejtë kushtetuese dhe ligjore, për gjykatën është një detyrim gjithashtu ligjor, që nuk lë shteg për ekuivoke.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çmojnë se mosrespektimi i këtij detyrimi ligjor, për të thirrur dhe njoftuar të pandehurin e lirë apo të arrestuar në gjykimin në apel përbën shkelje edhe të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetues, sipas të cilit, “Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor”.

Duke ju referuar rastit në shqyrtim, arrihet në përfundimin se konstatohet shkelje e dispozitave kushtetuese – neni 31 gërma “ç”, neni 33 pika 1 dhe 42 të Kushtetutës, neni 6 pika 3 gërma “c” të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe e kërkesave të parashikuara në nenin 426 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale.

Një moment tjetër i veçantë që duhet t’i nënshtrohet analizës gjithmonë në kuadrin e kësaj çështje, është edhe dallimi që duhet bërë midis “njoftimit” të të pandehurit dhe “njoftimit” të mbrojtësit, moment i cili konfundohej në praktikë. Sikundër edhe u përmend, gjykatat jo rrallë njësojnë pozicionin e mbrojtësit me atë të të pandehurit, duke “bazuara” apo “njësuar” të drejtat dhe detyrimet e këtyre dy subjekteve të procesit penal.

Është e vërtetë se mbrojtësi në përgjithësi ka të drejtat që ligji i njuh të pandehurit. Por ligji procedural, ka përcaktuar edhe kufijtë respektive në këto të drejta. Kështu në nenin 50 të Kodit Procedural Penal, parashikohet se:

1.”Mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njuh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit”.

Është pikërisht i pandehuri, i cili përcakton, gjithnjë në kuadër të kërkesave ligjore, kufijtë e të drejtave të mbrojtësit të tij. Edhe nga këndvështrimi i kërkesave të parashikuara në nenin 426 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, nuk mundet kurrsesi të “barazohet” thirrja e njoftimi i të pandehurit me mbrojtësin e tij. Në këtë dispozitë përcaktohet shprehimisht dhe në mënyrë të qartë ndarja e njerit subjekt nga tjetri: “Kryetari i Kolegjit të Gjykatës së Apelit urdhëron thirrjen e të pandehurit, paditësit civil dhe të paditurit civil, si dhe të mbrojtësve e të përfaqësuesve të tyre...”.

Siç u tha edhe më lart, në dispozitën e cituar të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet urdhërimi i thirrjes së të pandehurit në gjykimin, në gjykatën e apelit. Në pamje të parë, eventualisht mund të krijohet idea e gabuar se kemi të bëjmë thjesht me urdhërim për thirrje dhe vetëm kaq. Mirëpo, parë kjo dispozitë në koneksitet dhe unitet me dispozitat e tjera të Kodit të Procedurës Penale, arrihet në përfundimin se “urdhërimi për thirrje” i të pandehurit të lirë apo të arrestuar në gjykimin në apel, nuk mund të kuptohet dhe ndahet nga njoftimi i tij dhe rregullat procedurale që duhen zbatuar për këtë njoftim.

Me të drejtë mund të shtrohet pyetja, në se ekzistojnë dallime ndërmjet “urdhërimit për thirrje” dhe “njoftimit” të të pandehurit, në kuptim të kërkesave të pikës 1 të nenit 426 të Kodit të Procedurës Penale, por edhe më gjerë në dispozitat e tjera procedurale. Kolegjet e bashkuara, çmojnë se efektivisht dhe potencialisht ekzistojnë dallime.

Së pari, në parim ligj procedurale penale në dispozita të veçanta, parashikon dhe përcakton disponime të gjykatave me “urdhër” dhe në dispozita të tjera, parashikon dhe rregullon “Njoftimet”.

Së dyti, “urdhri” ka të bëjë në esencë me përcaktimin e një veprimi që duhet kryer, kush duhet ta kryejë dhe mjetin me të cilin do të kryhet.

Nga ana tjetër “njoftimet” kanë të bëjnë me anën “teknike” se si do të realizohet marrja dijani për një akt të caktuar, i cili mund të jetë thirrje, vendim, etj.

Megjithatë, duke qëndruar në vazhdim të analizës së problemit konkret, të koneksitetit dhe unitetit ndërmjet “urdhërimit të thirrjes” dhe “njoftimit” të të pandehurit, në kuptim të kërkesave të

nenit 426 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, tërhiqen disa përfundime.

Jo rrallë, gjykatat e apelit e kanë keqkuptuar këtë dispozitë. Vetë qëndrimet, herë herë të ndryshme të tyre, të nënvizuara në fillim të këtij arsytimi, konfirmojnë një gjë të tillë. Në jo pak raste, ato në fazën e veprimeve paraprake, formulojnë me shkrim urdhrin për thirrjen e të pandehurit të arrestuar apo të lirë, ia adresojnë atë organeve të policisë apo ftuesit përkatës dhe mbeten me kaq. Për këto gjykata, mjafton të evidentohet ky urdhërim në dosjen gjyqësore dhe sipas tyre, gjithçka është bërë në konformitet me kërkesat ligjore.

Mirëpo efektivisht në këto raste “harrohet” detyrimi tjetër ligjor, që ky urdhërim nuk mund të kuptohet pa realizimin e njoftimit të të pandehurit. Për ta ilustruar konekstitetin ndërmjet “urdhërimit të thirrjes” dhe “njoftimit” të të pandehurit, mjafton të shikohen përcaktimet që bëjnë psh nenet 349 dhe 350 të Kodit të Procedurës Penale.

Kështu në nenin 349 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet:

1. “Gjykata urdhëron edhe kryesisht që të përsëritet thirrja për gjykim kur del që i pandehuri ose personi ndaj të cilit është bërë kërkesë për gjykim nga i dëmtuari akuzues nuk ka marrë njoftim ose njoftimi është i dyshimtë.

Ndërsa në nenin 350 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet:

1. “Kur i pandehuri, qoftë edhe i paraburgosur, ose personi ndaj të cilit ka bërë kërkesë për gjykim i dëmtuari akuzues, nuk paraqitet në seancë...gjykata edhe kryesisht shtyn ose pezullon shqyrtimin gjyqësor, cakton datën e seancës së re dhe urdhëron që të përsëritet thirrja...

4.Kur del që njoftimi nuk ka qenë i rregullt, gjykata vendos shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor dhe urdhëron përsëritjen e njoftimit...”.

Në analizë sa më sipër, konkludohet se nuk mund të kuptohet një ndasi artificiale ndërmjet urdhërimit të thirrjes nga njoftimi i të pandehurit, sikundër në mënyrë të gabuar perceptohet nga gjykata te veçanta. Në këtë kuadër, gjykatat e apelit duhet të zbatojnë dhe respektojnë kërkesat ligjore që kanë të bëjnë me njoftimin e të pandehurit të lirë apo të arrestuar. Dhe konkretisht këto kërkesa janë të parashikuara në nenet 139 dhe 140 të Kodit të Procedurës Penale.

Si rrjedhojë, në rastin konkret të çështjes në gjykim, Gjykata e Apelit Shkodër, duhet të urdhëronte thirrjen e të pandehurve të arrestuar Qazim, Qamil dhe Zamir Lika, duke realizuar edhe njoftimin e tyre në konformitet me kërkesat ligjore të parashikuara nga neni 139 i Kodit të Procedurës Penale. Sipas kësaj dispozite, përcaktohet se:

1. “Njoftimi për të pandehurin e burgosur bëhet në vendin e burgimit duke i dorëzuar atij aktin.

2. Kur i pandehuri refuzon të marrë kopjen e aktit ose kur ai mungon për shkaqe të justifikuar, akti i dorëzohet përgjegjësit të institucionit, i cili për rastin e fundit njofton të interesuarin me mjetin më të shpejtë.

3.Dispozitat e mësipërme zbatohen edhe kur i pandehuri është i paraburgosur për një akuzë tjetër ose është duke vuajtur dënimin me burgim...”.

Duke mos zbatuar dhe respektuar kërkesat e parashikuara në nenet 31 gërma “ç” e 33 pika 1 të Kushtetutës, në nenin 6 pika 3 gërma “c” të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, kemi të bëjmë me shkelje të të drejtave kushtetuese dhe për pasojë me një proces të parregullt ligjor. Nga ana tjetër, duke moszbatuar dhe respektuar kërkesat e parashikuara nga nenet 426/1 e 139 të Kodit të Procedurës Penale, të gjitha aktet e realizuara nga ana e gjykatës së apelit në këtë gjykim, janë absolutisht të pavlefshme. Një përfundim i tillë arrihet, duke parë kërkesat e nenit 128 gërma “c” të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë dispozitë, e cila ka të bëjë me pavlefshmërinë absolute të akteve, përcaktohet se:

1.”Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me: .....

c. thirrjen e të pandehurit ose praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme”.

Nga sa u tha dhe analizua, rezulton se ndodhemi para kërkesave të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin nr.56 datë 2.5.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

## PËR KËTO ARSYE:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të kërkesave të nenit 142/1 të Kushtetutës dhe 441 pika “ç” të Kodit Procedurës Penale,

## V E N D O S Ë N:

Prishjen e vendimit nr.56 datë 2.5.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë Gjykatë.

Ky vendim unifikues për praktikën gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

## VENDIM

**Nr. 14, datë 16.2.2001**

### “NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

|                   |          |
|-------------------|----------|
| Thimjo Kondi      | Kryesues |
| Bashkim Caka      | Anëtar   |
| Agron Lamaj       | “        |
| Artan Hoxha       | “        |
| Kristaq Ngjela    | “        |
| Metush Saraçi     | “        |
| Natasha Sheshi    | “        |
| Nikoleta Kita     | “        |
| Perikli Zaharia   | “        |
| Tefta Zaka        | “        |
| Valentina Kondili | “        |
| Vladimir Bineri   | “        |
| Vladimir Metani   | “        |
| Ylvi Myrtja       | “        |
| Zamir Poda        | “        |

Në seancën gjyqësore të datës 16.2.2001 morën në shqyrtim çështjen civile që u përket:

PADITËS:Magdalena Mjelli, në mungesë.

I PADITUR:Brahim Mjelli, në mungesë.

OBJEKTI I PADISË: “Detyrim kthim sendi, salle bilardoje, korridor,llozhe përreth saj dhe një autoveturë “Audi”.

BAZA LIGJORE: Neni 296 i Kodit Civil.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr.336, datë 14.6.1999 ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë duke e detyruar të paditurin Brahim Mjelli t’i kthejë paditëses Magdalena Mjelli një sallë bilardoje, një koridor dhe një llozhë e ndërtuar në lagjen “1 Maji”, Kuçovë dhe autoveturën tip “Audi” me nr. shasie 059625, me targë KV 1086 A, me katër vende ngjyrë gri. Pushimin e gjykimit për shpërblimin e fitimit të munguar.

Gjykata e Apelit Vlorë (mbi ankimin e palës së paditur) me vendimin nr. 481, datë 17.9.1999 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 336, datë 14.6.1999 të Gjykatës së Rrethit Berat.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë ka bërë rekurs pala e paditur, e cila kërkon prishjen e vendimeve duke parashtruar këto shkaqe:

Gjykimi ne apel është bërë pa dijeninë time.

Vendimet janë të pambështetura në ligj pasi lokali është ndërtuar me kontributin e përbashkët të tre djemve të mi.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 12.12.2000, ka vendosur kalimin e

çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara, për unifikim të praktikës gjyqësore në lidhje me fillimin e afatit të rekursit kundër vendimit të dhënë në mungesë të palës që ushtron rekursin d.m.th.se rekursi mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dhënia e vendimit apo brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit.

## KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarë: Thimjo Kondi e Natasha Sheshi, e pasi e biseduan atë në tërësi,

### VËREJNË:

Gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë e në apel ka rezultuar si më poshtë:

Paditësja dhe vajzat e saj Nurjeda dhe Greta Mjelli janë trashëgimtarë ligjorë të rradhës së parë të të ndjerit Flamur Mjelli (vendimi nr.130, datë 2.10.1997 i Gjykatës së Rrethit Kuçovë).

Trashëgimlënësi, në vitin 1995, ka filluar ndërtimin e godinës objekt gjykimi, në përputhje me lejen e ndërtimit nr. 138, datë 30.3.1995 të KRRT Kuçovë.

I ndjeri ka arritur të ndërtojë një lokal që përdoret si sallë bilardoje, një korridor dhe një llozhë. Në përfundim të punimeve të kryera nga 5.3.1995-31.8.1995 është mbajtur një situacion përfundimtar i firmosur prej tij.

Paditësja ka paraqitur në gjykim edhe vendimin nr.144 datë 13.10.1997 të Gjykatës së Rrethit Kuçovë me kërkuese paditësen, me person të tretë Zyrën Urbanistike pranë Bashkisë Kuçovë, sipas të cilit paditësja dhe fëmijët e saj janë bashkëpronarë të ndërtesës objekt gjykimi.

Gjithashtu rezulton se i ndjeri Flamur Mjelli ka qenë pronar i automjetit tip “Audi” me nr. shasie 059625.

Aktualisht objekti dhe automjeti përdoren nga i padituri (babai i të ndjerit).

Në gjykatën e apelit çështja është gjykuar më datë 17.9.1999. Njoftimi për ditën e gjykimit në apel është bërë me shpallje (neni 460/1 i Kodit të Procedurës Civile). I padituri nuk ka marrë pjesë gjatë gjykimit në apel. Rekursi i të paditurit kundër vendimit të gjykatës së apelit është depozituar me datën 25.10. 1999.

Dispozitat procedurale lidhur me afatin e rekursit janë formuluar si më poshtë:

Në bazë të nenit 443/2 të Kodit të Procedurës Civile “Afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë”.

Fillimi i afateve të ankimit parashikohet në nenin 444 të Kodit të Procedurës Civile. Në paragrafin e parë të këtij neni thuhet: “Afatet e përcaktuara në nenin 443 janë të prerë dhe fillojnë nga dita e shpalljes së vendimit përfundimtar. Kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë në mungesë të njëres palë, ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit”.

Gjithashtu rekursi në Gjykatën e Lartë, pavarësisht nga njoftimi, nuk mund të bëhet mbasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit (neni 445 i Kodit të Procedurës Civile). Kjo dispozitë nuk zbatohet kur pala në mungesë vërteton se nuk ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve.

Sipas nenit 460/3 të Kodit të Procedurës Civile, njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatat përkatëse të shkallës së parë, jo më vonë se 10 ditë përpara shqyrtimit të çështjes.

Mosparaqitja e palëve në gjykatën e apelit, për të cilat njoftimi është bërë me shpallje nuk pengon shqyrtimin e çështjes, me përjashtim të rastit kur janë njoftuar shkaqe të arsyeshme për mungesë (neni 461/2 i Kodit të Procedurës Civile).

Ndërsa në nenin 476/1 të Kodit të Procedurës Civile është parashikuar se: “Rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, në afarin prej 30 ditësh nga njoftimi që u është bërë palëve”.

Krahas dispozitave të cituara më sipër, në Kodit të Procedurës Civile ka edhe një dispozitë të përgjithshme për llogaritjen e afateve, sipas të cilës, “Kur afati është caktuar me ditë dhe me orë, përjashtohet dita dhe ora në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati (neni

148/1 i Kodit të Procedurës Civile)”.

Lidhur me problemin për të cilin u kërkohet të përcaktojnë një qëndrim të unifikuar, me qëllim që të shmangen në të ardhmen qëndrime të ndryshme e të kundërta me njeri-tjetrin, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së lartë janë të mendimit se:

Në rastet kur gjykimi në apel bëhet në mungesë të palës, por janë respektuar kërkesat 460 e 461 të Kodit të Procedurës Civile për mënyrën e njoftimit të palëve, verifikimin e shkaqeve të mungesës dhe rregullsinë e njoftimit, vendimi përfundimtar i gjykatës së apelit duhet t’i njoftohet palës në mungesë dhe afati 30 ditor i rekursit llogaritet nga e nesërmja e ditës së njoftimit.

Përfundimin e mësipërm, Kolegjet e Bashkuara e nxjerrin nga analiza në tërësi e dispozitave procedurale të cituara më lart, të cilat rregullojnë afatet procedurale dhe mënyrën e llogaritjes së tyre, duke trajtuar këtë analizë në korelacion me përmbajtjen e nenit 1 paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Civile.

Sipas kësaj dispozite, “Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërtënie ose është i paqartë”. Ky rregull është i zbatueshëm jo vetëm për zgjidhjen në tërësi të një çështjeje të caktuar nga gjykata, së cilës i është paraqitur për shqyrtim, por edhe aspekte apo problemeve të veçanta të saj, si të së drejtës materiale, ashtu edhe të së drejtës procedurale. Dispozita e Kodit të Procedurës Civile, të cituara më lart, të cilat rregullojnë afatet procedurale dhe mënyrën e llogaritjes së tyre, nga mënyra e formulimit të tyre, në mënyrë evidente paraqesin paplotësi, paqartësi e kundërtënie.

Është detyim kushtetues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që buron prej nenit 141/2 të Kushtetutës, për t’u dhënë këtyre dispozitave kuptimin e duhur duke plotësuar boshllëqet, duke qartësuar anët e errëta e duke shmangur kundërtënitë. Në funksion të këtij qëllimi, interpretimi i unifikuar i këtyre dispozitave procedurale duhet të bëhet në mënyrën që është më e favorshme për palën që kërkon të përfitojë prej tyre. Në rastin në shqyrtim pala që kërkon të përfitojë është pala që ka qenë në mungesë të gjykimit në apel dhe që ka paraqitur rekurs për në Gjykatën e Lartë.

Po cilat janë konkretisht mungesat, paqartësitë e kundërtënitë e dispozitave në fjalë?

Neni 443/2 i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Kasacionit (e Lartë), kundër vendimeve të apelit, është 30 ditë, por nuk parashikon se nga cili moment fillon të llogaritet ky fat. Ndërsa neni 472 paragrafi i fundit i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se kundërshtimi i vendimit në Gjykatën e Kasacionit (e Lartë) bëhet brenda 30 ditëve nga dhënia e vendimit të Gjykatës së Apelit...

Deri këtu duket sikur dispozita e dytë plotëson dhe qartëson të parën, por më tej, neni 476/1 i Kodit të Procedurës Civile paraqet një formulim që u bie ndesh dy dispozitave të mësipërme. Sipas kësaj dispozite, “Rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin në afatin prej 30 ditësh nga njoftimi që u është bërë palëve”. Shprehja e mësipërme e nënvizuar nuk mund të ketë tjetër kuptim, veçse: momenti i njoftimit, nga i cili fillon të llogaritet afati 30 ditor, për palën e pranishme përkon me momentin e shpalljes së vendimit, ndërsa për palën në mungesë ky moment përkon me kohën kur kjo palë vihet në dijeni zyrtarisht për përmbajtjen e vendimit.

Gjithashtu, formulimi i kësaj dispozite nënkupton detyrimin e gjykatës së apelit për t’ia komunikuar vendimin palës që ka qenë në mungesë.

Ndërsa neni 444 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se afatet e ankimit fillojnë nga dita e shpalljes së vendimit përfundimtar, neni 148/1 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se kur afati është përcaktur me ditë..., përjashtohet dita...në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati, d.m.th. afati fillon të llogaritet nga dita e nesërme.

Në këtë rast ndeshja midis dy dispozitave është evidente.

Ndërsa neni 444, në paragrafin e parë të tij, parashikon se kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë në mungesë së njerës palë, afati i ankimit fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Pra, kjo dispozitë parashikon në mënyrë të shprehur detyrimin e gjykatës së shkallës së parë që t’i njoftojë vendimin palës që ka qenë në mungesë, ndërsa hesht për gjykatën e apelit. Prej interpretimit nga e kundërta (ad contrario) të dispozitës së mësipërme konkludohet se afati i rekursit kundër vendimit të apelit edhe për palën tjetër që ka qenë në mungesë fillon nga dita e dhënies së vendimit dhe jo nga dita e njoftimit të vendimit. Kjo është harmoni me nenin 472, paragrafi i fundit,



të Kodit të Procedurës Civile, por bie ndesh me nenin 476/1 të këtij Kodi.

Janë pikërisht mungesat, paqartësitë e kundërthëniet e dispozitave procedurale të cituara më lart, arsyet që imponojnë arritjen e interpretimit të unifikuar në bazë të analizës e pëfundimeve të parashtruara.

Qëndrimi i unifikuar i arritur në këtë vendim është në harmoni edhe me një vendim të mëparshëm të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në vendimin nr.629, datë 15.05.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së lartë, ndër të tjera, arsyetohet si më poshtë:

“...Vendimi i Gjykatës së Kasacionit nr.695, datë 19.03.1999 duhet të priset me zbatim të gabuar të ligjit procedural. Kjo Gjykatë ka bërë thjesht një numurim të ditëve të afatit të ushtrimit të rekursit, sipas parashikimeve të neneve 443/2 dhe 444/2 të Kodit të Procedurës Civile, por nuk ka pasur parasysh modalitetet e nenit 445 të Kodit të Procedurës Civile.

Sipas dispozitave të mësipërme, si dhe të nenit 444/1 të Kodit të Procedurës Civile, është e vërtetë që afati i rekursit kundër vendimeve të gjykatës së apelit në Gjykatën e Lartë është 30 ditë dhe ky afat është i prerë.

Megjithatë, neni 445 i Kodit të Procedurës Civile, parashikon ndër të tjera, se “...rekursi në Gjykatën e Kasacionit (e Lartë)...pavarësisht nga njoftimi, nuk mund të bëhen mbasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit...”. Njëpër një interpretimit të kësaj dispozite, arrihet në përfundimin se, pavarësisht nga rregulli i përgjithshëm i parashtruar më lart, sipas të cilit afati i rekursit është 30 ditë dhe ky afat është i prerë, dmth. nuk mund të rivendoset apo të zgjatet tej 30 ditëshit, ekziston edhe një përjashtim, ndryshe dispozita e sipërpërmendur, që parashikon afatin prekluziv 1 vjeçar, nuk do të kishte kuptim. Përjashtimi duhet të gjendet tek zbërthimi i kuptimit të shprehjes “pavarësisht nga njoftimi”. Kuptohet që është fjala për njoftimin e vendimit të gjykatës së shkallës së dytë palës që ka qenë në mungesë...”.

Sa më lart është një argument më tepër në mbështetje të interpretimit të unifikuar që bëhet me këtë vendim.

Përsa i përket zgjidhjes së çështjes në themel, Kolegjet e Bashkuara janë të mendimit se çështja është zgjidhur në pajtim me ligjin, prandaj vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë duhet të lihet në fuqi.

Paditësja dhe dy vajzat e saj janë të vetmit trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të të ndjerit Flamur Mjelli. Eshhtë e vërtetë që ajo nuk ka paraqitur ndonjë titull pronësie për të provuar pronësinë ekskluzive të trashëgimlënësit mbi pasurinë e paluajtëshme trashëgimore (akt-noterial, vendim gjyqësor me palë kundërshtarë, regjistrim hipotekor etj), por ajo me një sërë provash të tjera të lira, të vlerësuara në tërësinë e tyre, ka krijuar bindje tek gjykata e faktit që ajo dhe ish-bashkëshorti i saj kanë krijuar bashkëpronësin bashkëshortore të lokalit të ndërtuar, si dhe të automjetit. Pretendimi i të paditurit, sipas të cilit lokali është ndërtuar me kontributin e përbashkët e tre djemve të tij, ka mbetur i paprovuar. Ai nuk ka paraqitur në gjykim asnjë provë për të provuar pretendimin e tij. Nga ana tjetër, është jashtë kufijve të shqyrtimit nga Gjykata e Lartë, mënyra e vlerësimit të provave nga gjykata e faktit.

Edhe pretendimi tjetër, që gjykimi në apel është bërë pa pasur njoftim, nuk qëndron. Sipas nenit 460/3 të Kodit të Procedurës Civile, njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve bëhet nga gjykata e apelit me shpallje...dhe jo me njoftim të drejtëpërdrejtë të palëve.

#### PËR KËTO ARSYE:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 141/2 të Kushtetutës dhe nenit 485, pika “a”, të Kodit të Procedurës Civile,

#### V E N D O S Ë N:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.481, datë 17.9.1999 të Gjykatës së Apelit Vlorë.
2. Ky vendim për unifikimin e praktikës gjyqësore, të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

## MENDIMI I PAKICËS

Në lidhje me unifikimin e praktikës gjyqësore, përsa i përket fillimit të afatit të paraqitjes së rekursit kundër vendimit të dhënë nga gjykata e apelit në mungesë të palës, që ushtron rekursin parashtrorjëm:

-Çështja është gjykuar në datën 17.9.1999. Njoftimi për ditën e gjykimit në apel është bërë me shpallje (neni 460/1 i Kodit të Procedurës Civile). I padituri nuk ka marrë pjesë në gjykimin në apel.

Rekursi i të paditurit kundër vendimit është paraqitur me 25.10.1999.

Përsa parashtrorhet shtrohen dy probleme:

-Kur fillon afati i paraqitjes së rekursit.

-Nëse vendimi i gjykatës së apelit duhet t'i komunikohet palës në mungesë, e lidhur kjo me përcaktimin e datës së fillimit të afatit për paraqitjen e rekursit.

Është detyrim kushtetues parashkuar nga nenet 42 e 43 të Kushtetutës, që kushdo për mbrojtjen e të drejtave të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore...ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e caktuar me ligj. Gjithashtu kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç se kur në Kushtetutë parashkohet ndryshe.

Për të realizuar të drejtën e tij kushtetuese, paditësi i ishte drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat e cila ka zhvilluar gjykimin sipas kërkesave procedurale.

Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ka paraqitur ankim i padituri.

Gjykata e Apelit Vlorë ka shqyrtuar çështjen në datë 17.9.1999 në mungesë të të paditurit.

Kodi i Procedurës Civile ka parashkuar rregullat e përgjithshme dhe të posaçme të njoftimeve, afatet për kryerjen e veprimeve procedurale dhe mjetet ligjore të mbrojtjes, duke përcaktuar dhe afatet për ushtrimin e tyre.

Për sa i përket njoftimeve në lidhje me procesin gjyqësor në shkallë të parë bëhet nëpërmjet letër-thirrjeve që njoftohen sipas procedurave të parashkuara nga neni 128-144 Kodit të Procedurës Civile. Pas përfundimit të gjykimit, shkalla e parë jep vendimin përfundimtar. Afati i ankimit në gjykatën e apelit kundër vendimeve përfundimtare është 15 ditë (neni 433 Kodit të Procedurës Civile). Ky afat fillon nga dita e shpalljes së vendimit përfundimtar dhe kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, në mungesë të njëjës palë, ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit.

Pra në kreun e dispozitave të përgjithshme, në lidhje me mjetet e ankimit, parashkohet qartë se vetëm vendimi përfundimtar i gjykatës së shkallës së parë i komunikohet palës në mungesë. Ç'ka konfirmon realizimin e së drejtës kushtetuese.

Kur çështja kalon për gjykim në gjykatën e apelit, njoftimi, për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve, bëhet nga Gjykata e Apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatat përkatëse të shkallës së parë, jo më vonë se 10 ditë përpara shqyrtimit të çështjes (neni 460 Kodit të Procedurës Civile ky njoftim u bëhet drejtpërdrejt palëve vetëm në kushtet e paragrafit të fundit të nenit 460 Kodit të Procedurës Civile). Mënyra e njoftimit për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve prej Gjykatës së Apelit është e posaçme dhe kjo mënyrë njoftimi nënkupton se pas përfundimit të gjykimit prej gjykatës së faktit dhe realizimit të së drejtës së ankimit tashmë janë palët ato që janë të interesuara për t'u vënë në dijeni për ditën dhe orën e gjykimit të çështjes. Përderisa gjykata nuk ka detyrim ligjor për të vënë palët në dijeni të procesit gjyqësor nëpërmjet njoftimit drejtpërdrejt palëve kuptohet që nuk ka as detyrim për t'u njoftuar vendimin e palëve në mungesë, prandaj dhe një detyrim i tillë nuk është parashkuar.

Nisur nga sa u parashtrua më sipër rezulton se afati për kundërshtim të vendimit të Gjykatës së Apelit fillon nga dhënia e vendimit të Gjykatës së Apelit (nga e nesërmja si dhe është pranuar nga Kolegjet e Bashkuara të kësaj gjykate). Momenti i fillimit të afatit të rekursit është përcaktuar në paragrafin e fundit të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ç'ka është në harmoni me përmbajtjen e nenit 444 Kodit të Procedurës Civile.

I vetmi rast kur pala legjitimohet të paraqesë rekurs jashtë afatit 30 ditor nga dhënia e vendimit, prej Gjykatës së Apelit është vetëm kur ajo vërteton parregullsi të njoftimit për ditën dhe orën e gjykimit të çështjes (moshpallje, gabime të dukshme në përcaktimin e palëve etj.).

Interpretimi që bëhet prej shumicës së detyrimi për njoftimin e vendimit rezulton nga përmbajtja e nenit 476 Kodit të Procedurës Civile nuk është ligjor. Tek neni 476 i Kodit të Procedurës Civile parashikohet e rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin në afatin prej 30 ditësh nga njoftimi që u është bërë palëve.

Në këtë dispozitë nuk përcaktohet mënyra e njoftimit, por ky moment përcaktohet qartë nga përmbajtja e nenit 472 Kodit të Procedurës Civile Përderisa kundërshtimi i vendimit në Gjykatën e Lartë bëhet brenda 30 ditëve nga dhënia e vendimit të Gjykatës së Apelit nënkuptohet se ky është momenti i njoftimit të vendimit. Vetë rregullat procedurale të vendosura për njoftimet prej gjykatës së apelit janë të tilla që të investojnë palën e interesuar për zhvillimin e procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe realizimin e të drejtës së rekursit sepse pranimi i së kundërtës nuk gjen mbështetje ligjore dhe do të sillte zvarritje të dukshme të procesit gjyqësor. Kështu ky qëndrim favorizon palën që nuk tregon interes për ndjekjen e procesit gjyqësor, sepse mosparaqitja e palëve për shkaqe të arsyeshme pengon shqyrtimin e çështjes. Ky veprim procedural parashikohet tek paragrafi II i nenit 461, sipas të cilit “Mosparaqitja e palëve për të cilat njoftimi është bërë me shpallje nuk pengon shqyrtimin e çështjes me përjashtim të rastit kur janë njoftuar shkaqe të arsyeshme për mungesën”.

Për këto arsye vendimi i shumicës nuk gjen mbështetje ligjore.

## **UDHËZIM**

**Nr. 25, datë 23.4.2001**

### **PËR MËNYRËN E NGRITJES SË QENDRAVE TË RISHIKIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE DHE GRUPEVE TRESHE TË VERIFIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 8609, datë 8.5.2001 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe në zbatim të vendimit të KQZ-së nr. 171, datë 10.4.2001 “Për miratimin e manualit për rishikimin e listave paraprake të zgjedhësve”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

#### **UDHËZON:**

1. Në bashkitë që, për efekt pagash, janë caktuar të kategorisë së parë dhe në komunat me mbi 10 00 votues, procesi i rishikimit të listave organizohet dhe realizohet nga KZQV-të, përmes krijimit të Qendrave të Rishikimit të Listave Zgjedhore (QRLZ). Në gjithë bashkitë dhe komunat e tjera, rishikimi i listave kryhet direkt nga KZQV-ja përkatëse.

Numri i këtyre qendrave, si rregull, do të jetë mesatarisht 1 për çdo 8000 votues (duke iu referuar numrit të qendrave të përdorura për rishikimin e listave dhe lëshimin e kartave të votuesve, para fushatës zgjedhore të qeverisjes vendore të 1 tetorit 2000). Ky rregull është i vlefshëm edhe për KZQV-në e Bashkisë së Tiranës dhe 11 KZQV-të e njësisve bashkiake të saj.

2. KZQV-ja përcakton veças, për secilën QRLZ, territorin dhe numrin e qendrave të votimit të përfshira brenda tij dhe i jep QRLZ-së të gjitha modelet e listave të dërguara nga KQZ-ja për qendrat e votimit, që janë brenda territorit të saj, për të kryer procedurat sipas përcaktimeve në “Manualin KZQV-së për rishikimin e listave paraprake të zgjedhësve”, për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të qershorit 2001.

3. Çdo QRLZ do të ketë 3 punonjës rishikimi të cilët propozohen: një nga kryetari i bashkisë apo komunës, një nga partitë në pozitë dhe një nga partitë në opozitë që kanë përfaqësim në këshillin përkatës të pushtetit vendor. Mbi bazën e këtyre propozimeve, KZQV-ja nxjerr vendimin për emërimin e tyre dhe në bashkëpunim me kryetarin e bashkisë apo komunës, caktojnë njëkohësisht

edhe ambjentin (zyrën) ku do të instalohet dhe punojë QRLZ-ja, e cila duhet të jetë e pajisur edhe me telefon.

Vendndodhja e QRLZ-së publikohet në çdo vend afishimi të listave të zgjedhësve për secilën qendër votimi. Orari i punës së saj është i njëjtë me orarin e caktuar nga KQZ-ja për KZQV-të.

4. QRLZ-ja kryen punën sipas përcaktimeve në manualin e përmendur në pikën 2 të këtij udhëzimi. Për zgjedhësit që ankohen në QRLZ, punonjësit e rishikimit, mbështetur në dokumentin e indentifikimit, sipas rastit, bëjnë korrigjimin e elementit ku vërtetohet pasaktësia (emër, atësi, mbiemër, datëlindje, seks, në numrin e qendrës së votimit), si dhe vendosin statusin e votuesit në kolonën përkatëse dhe çdo të enjte, dokumentacionin e plotësuar prej tyre ia paraqesin KZQV-së për miratim, duke evidentuar veças çdo zgjedhës të cilit i është ndryshuar statusi përmes vendosjes së shenjës “V” ose ”L”.

5. KZQV-ja sipas një ndarjeje që bën vetë, mbikëqyr dhe kontrollon në vazhdimësi punën e QRLZ-ve dhe përgjigjet para KQZ-së për cilësinë e realizimit të këtij procesi.

Për krijimin e grupeve treshe të verifikimit shtëpi më shtëpi:

1. Gjithë KZQV-të e bashkive apo komunave që nuk krijojnë QRLZ, si rregull, ngrenë një grup tresh të verifikimit shtëpi më shtëpi, të përbërë nga një anëtar i propozuar nga kryetari i bashkisë apo komunës, një nga partitë në pushtet dhe një nga partitë në opozitë që kanë përfaqësim në këshillin përkatës të pushtetit vendor. Kur volumi i punës nuk përballohet nga një grup tresh, problemi i prezantohet supervisorit (mbikqyrësit) të KQZ-së së caktuar në çdo prefekturë, i cili, menjëherë, në rrugë telefonike kontakton me KQZ-në dhe autorizon ngritjen e grupit apo grupe shtesë.

2. Në KZQV-të që ngrenë QRLZ, sipas mënyrës së përcaktuar në pikën 1 më sipër, fillimisht ngrihet nga një grup të verifikimit shtëpi më shtëpi për çdo QRLZ dhe, nëse volumi i punës së këtyre grupeve është i madh, veprohet si në pikën 1 për të shtuar grupet e verifikimit.

3. Grupi tresh është i detyruar të plotësojë çdo detyrë që i caktohet nga KZQV-ja apo QRLZ-ja, sipas përcaktimit në manualin e KZQV-së, dhe të kthejë, në kohën e caktuar, formularët shtesë të dhënë për verifikim dhe për secilin prej tyre, jep me shkrim rekomandimin e tij për KZQV-në, duke firmosur të tre anëtarët.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ilirian Celibashi**

**V E N D I M**  
**Nr. 41/1, datë 16.4.2001**

**PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN LOKAL PRIVAT “TELE-SPORT”**  
**SUBJEKTIT: SHOQËRIA “TELE SPORT” SH.P.K.**

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 8655, datë 31.7.2000, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

**V E N D O S I:**

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Tele Sport” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv lokal privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj liçence.

2. Licenca, bashkëlidhur përmban kushtet e licences, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Sefedin Çela**

**VENDIM (I SHKURTUAR)**  
**Nr. 136 datë 12.5.2000**

**PËR EMËRIM KUJDESTARI**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbini ka vendosur:

1. Heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Esat Idriz Porja, i biri i Idrizit dhe i Dushes, i datëlindjes 18 janar 1949, lindur në Macukull të rrethit Mat e banues në lagjen “Drita”, Mamurras.
2. Të caktojë si kujdestar të përhershëm të shtetasit Esat Porja, kerkuesin Mexhit Porja.

**V E N D I M**  
**(PËR CAKTIM KUJDESTARI)**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në bazë të nenit 306 të Kodit të Procedurës Civile, me vendimin 249, datë 23.5.2000, vendosi caktimin e Sami Lytifi Shyti si kujdestar të të miturve Nerila Guri Shyti dhe Irma Guri Shyti.

**V E N D I M**  
**(PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR)**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, në bazë të neneve 306 dhe 375 të Kodit të Procedurës Civile, me vendimin nr.98, datë 9.4.2001, shpall të zhdukur shtetasin Gjyzel Esheref Fida.

**V E N D I M**  
**(PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR)**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, neneve 306 dhe 375 të Kodit të Procedurës Civile, me vendimin nr.102, datë 10.4.2001, shpall të zhdukur shtetasin Atli Abdulla Hakorja.

**K Ë R K E S Ë**  
**(PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR)**

Kërkuese: Roza Xheladini, e bija e Ramizit dhe Ervehesë, lindur në 1958 në Osmenzeze, Berat dhe banuese në Ballsh, e divorcuar.

Objekti: “Shpalljen e zhdukjes së bashkëshortit tim Kujtim Skënderaj, në bazë të neneve 375, 376 të Kodit të Procedurës Civile”.

Unë, kërkuesja Roza Xheladini kërkoj të shpallet i zhdukur bashkëshorti im, Kujtim Skënderaj. Në 15 nëntor 1993 u nis për në Greqi. Nga data e nisjes kanë kaluar 7 vjet dhe unë nuk kam asnjë informacion për vendndodhjen e tij. Sa më sipër kërkoj nga gjykata të shpallet i zhdukur bashkëshorti im, Kujtim Skënderaj.

**KËRKUESI**  
**Roza Xheladini**

Fletorja Zyrtare gjendet:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,  
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 4.5.2001  
Doli nga shtypi më 7.5.2001

Tirazhi: 4100 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “At Gjergj Fishta”, Tiranë

Çmimi: 150 lekë